KOMUNA GURI I ZI



PLANI STRATEGJIK
I ZHVILLIMIT
TË KOMUNËS GURI I ZI

KOMUNA GURI I ZI

PLANI STRATEGJIK

I ZHVILLIMIT

Të KOMUNËS GURI I ZI

Përgatitur nga: KOMUNA GURI I ZI

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dldp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri URBAPLAN, Zvicer

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Guri i Zi - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT

inter cooperation
Natural Resource Management
Rural Economy
Local Governance and Civil Society

dldp
decentralisation and local development programme

Co-PLAN
INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT
INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HABITATIT

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Condeferazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania

Tabela e Përmbajtjes

FJALA E PËRSHËNDETJES 5

MIRËNJOHJE 7

HYRJE 9

KAPITULLI I

Struktura e përgjithshme 13
1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Komunën Guri i Zi? 13
1.2 Nevoja për një Plani Strategjik Zhvillimi në Gurin e Zi 14
1.3 Parimet dhe objektivat ku mbështetet Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi 14
1.4 Struktura e dokumentit 15
1.5 Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi 16

KAPITULLI II

Përmbledhje e profilit - Komuna Guri i Zi 19
2.1 Pozicioni Gjeografik dhe Karakteristikat Natyrore 20
2.2 Zhvillimi Rajonal 22
2.3 Të dhëna Historike 24
2.4 Zhvillimi i Territorit të Komunës 24
2.5 Të Dhëna për Pronësinë e Tokës 25
2.6 Profili Ekonomik i Komunës 26
2.7 Financat e Komunës 27
2.8 Mundësitë për Zhvillim Ekonomik 27
2.10 Punësimi 29
2.11 Shërbimet Publike 30
2.12 Furnizimi me Ujë 30
2.13 Kanalizimet e Ujërave të Zeza 31
2.14 Infrastruktura Rrugore 31
2.15 Shërbime të Tjera 32
2.16 Mbeturinat Urbane 32
2.17 Demografia 33
2.18 Zhvillimi Social 34

KAPITULLI III

Zhvillimi i Ardhshëm i Propozuar në Komunën Guri i Zi 41
3.1 Vizioni i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi 41

3.2 Drejtimet e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi sipas Përcaktimeve të Grupit të Qytetarëve 42
3.3 Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës 42
3.4 Rezultatet e Pritshme dhe Veprimet Konkrete të Propozuara për Zhvillimin e Komunës Guri i Zi 43
3.4.1 Objektivi A - Zhvillimi Ekonomik i Komunës 43
3.4.2 Objektivi B - Menaxhimi i Territorit në Komunën Guri i Zi 45
3.4.3 Objektivi C - Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve Publike në Komunën Guri i Zi 52
3.4.4 Objektivi D - Qeverisja e Mirë 54
3.4.5 Objektivi F - Zhvillimi i Burimeve Financiare në Komunën Guri i Zi 56

KAPITULLI IV

Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit Lokal të propozuar për Komunën Guri i Zi 61
4.1 Ndërhyrjet Institucionale të Propozuara 61
4.2 Plani i Detajuar i Veprimit 62
4.2.1 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2008 62
4.2.2 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2009 62
4.2.3 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2010 66
4.2.4 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2011 69
4.2.5 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2012 71
4.2.6 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2013 74
4.2.7 Plani i Veprimit - Strategjia e Zhvillimit të Komunës Guri i Zi - Viti 2014 76
4.3 Skema e monitorimit dhe treguesit përkatës 77

Fjala e Përshëndetjes

Ideja për të hartuar një Plan Strategjik Zhvillimi për Komunën tonë ka qenë e kahershme. Që në fillim të vitit 2002 është hartuar dhe prezantuar në Forumin Rural një draft për drejtimet e zhvillimit strategjik të Komunës Guri i Zi në të ardhmen. Duhet theksuar, se pjesërisht për shkak të mungesës së përvojës, apo për shkak të kapaciteteve të kufizuara, përmbajtja e materialit të paraqitur në Forum kishte disa mangësi.

Për këtë arsye, një nga kërkesat e para të Komunës gjatë krijimit dhe konsolidimit të bashkëpunimit me organizatën zvicerane Intercooperation Albania, ishte pikërisht vazhdimi dhe finalizimi i kësaj nisme.

Sot, me kënaqësi konstatojmë realizimin e kësaj kërkese dhe domosdoshmërie për Komunën tonë, mbi të gjitha në saje të punës së përkushtuar dhe mjaft cilësore të grupit të ekspertëve të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme dhe frytdhënëse nga Intercooperation Albania

Dëshiroj të përgëzoj angazhimin qytetar të Grupit të Komunitetit në Komunë, të cilët dhanë një kontribut të vyer për realizimin e këtij plani të rëndësishëm ambicioz. Përshëndes në këtë mënyrë grupet tematike të zhvillimit bujqësor dhe blegtoral, grupin e zhvillimit mjedisor, turizmit, grupin e çështjeve sociale etj.

Me këtë rast, shpreh angazhimin serioz të komunës Guri i Zi, për kthimin e Planit Strategjik të Zhvillimit në një busull orientimi për një zhvillim të përbashkët në vitet në vazhdim.

Me respekt!

BROZ MARKU
Kryetari i Komunës Guri i Zi

Mirënjohje

Ky dokument është përgatitur gjatë periudhës Maj 2007-Maj 2008, si produkt i një pune të përbashkët mes Komunës Guri i Zi, përkatësisht grupit të saj të punës, ekspertëve të Intercooperation Albania, me qendër në Shkodër, ekspertëve të Co-PLAN (Instituti për Zhvillimin e Habitatit) e pa dyshim ndihmesën e çmuar të ekspertëve nga UrbaPlan me qendër në Zvicër.

Falënderime të veçanta shkojnë në emër të Kryetarit të Komunës Guri i Zi, Z. Broz Marku, i cili, me këmbënguljen dhe angazhimin serioz të tij mbështeti plotësisht të gjithë procesin për hartimin e dokumentit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës.

Gjithashtu, mirënjohje i dedikohet komunitetit të Komunës Guri i Zi dhe përkatësisht Grupit të Përfaqësimit Qytetar, që me përfshirjen dhe komentet e tij me vlerë dha ndihmesë të çmuar për hartimin dhe finalizimin e këtij plani.


Së fundmi, grupi i përbashkët i punës shpreh mirënjohje ndaj Intercooperation Albania për mbështetjen e pakursyer dhe eksperiencën unike që lehtësoi përgatitjen e të gjithë materialit në vijim.

Grupi i Punës në Komunën Guri i Zi: Z. Alfred Haxhari, Z. Lazër Ilia, Znj. Ardiana Marku, Znj. Veronika Hila, Z. Gëzim Selmani.

Përfaqësuesit e Grupit të Qytetarëve në Komunën Gur i Zi: Z. David Haxhari, Z. Selim Meti, Z. Arian Gjura, Znj Gjyste Matishi, Z. Artur Rama, Z. Adi Garuci, Z. Barjam Dedja, Znj. Ariola Zefi, Z. Paulin Vuka, Z. Lazër Ilia, Z. Çesk Guraziu, Znj. Adriana Marku, si dhe shumë përfaqësues të tjerë të cilët mund të mos jenë përmendur.

Ekipi Co-PLAN: Z. Enton Derraj, Znj. Darina Kokona, Z. Dritan Shutina, Z. Florian Ravoniku, Znj. Elona Saro, Z. Indrit Faja.

Intercooperation Albania: Z. Pascal Arnold, Znj, Valbona Karakaçi, Z. Aljon Koçkiq.



Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi, vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)** në rajonin e Shkodrës, që po zbatohet nga Intercooperation Albania.

Komuna Guri i Zi është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfituese të këtij programi, krahas Bashkive Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz, Koplik si dhe Komunave Velipojë e Dajç.

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal në Rajonin e Shkodrës, i cili është në fazën e parë të zbatimit të tij (2006 – 2009) është financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatuar nga Intercooperation Albania (organizatë zvicerane jo fitimprurëse që operon në rajonin e Shkodrës). Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me qendër në Tirane, u kontraktua me cilësinë e ekspertit vendas për të asistuar gjashtë njësitë e qeverisjes vendore në rajonin e Shkodrës, përkatësisht Bashkitë Koplik, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz si dhe Komunat Dajç e Guri i Zi, në përgatitjen e dokumenteve të tyre të zhvillimit të tillë si Planet Strategjike të Zhvillimit dhe po ashtu Planet e Përgjithshme Rregullues për Bashkitë Vau Dejës e Koplik në përputhje me termat e referencës për secilën prej tyre.

Ky Program (**DLDP**) synon drejt përmirësimit të qeverisjes në nivelin vendor, konkretisht:

- përmirësimin e komponentëve të qeverisjes vendore,
- menaxhimin dhe administrimin të shërbimeve,
- mbështetjen e proceseve të decentralizimit dhe transicionit në vend,
- zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Hartimi i Planit Strategjik të Zhvillimit për çdo njësi vendore të përfshire, nëpërmjet një procesi përgatitor me pjesëmarrjen e qytetarëve, përbën boshtin kryesor të programit. Qëllimi i tij është pajisja e autoriteteve vendore me një dokument bazë strategjik, i cili identifikon prioritetet kyçe të zhvillimit për njësinë vendore si dhe propozon format e zhvillimit në aspektin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit.



Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi është përshtatur, pasuruar dhe pjekur përgjatë një procesi të hapur pjesëmarrjeje, i cili ka vënë në lëvizje strukturat vendore, grupin e qytetareve të përfshire në cikle seminaresh debatuese dhe konsultative të hapura për të gjithë komunitetin vendas në çdo fazë të hartimit të planit.





Pamje të procesit të përgatitjes së planit në Komunën Guri i Zi

Në këtë grup u përfshinë përfaqësues të administratës së Komunës, Këshillit Vendor të saj, grupe të ndryshme interesi (biznese, emigrantë, fermerë, etj), përfaqësues të Qarkut të Shkodrës si një partner i rëndësishëm në zbatimin e mëtejshëm të këtij dokumenti, përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse (OJF) apo organizatave me bazë komunitare.


KUÇI
VUKATANA
KRENCI
JUBANI
GURI I ZI
GAJTANI
SHPELLA E GAJTANIT
SHPELLA E JUBANIT
KALLJA E FURXELLES
SPATHARI
GANJOLLA
LUMI DRIN

Kapitulli I

Struktura e Përgjithshme

1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Komunën Guri i Zi?

Një plan novator; për të parën herë Komuna Guri i Zi ka një Plan Strategjik Zhvillimi duke hapur rrugën për një përqasje më të organizuar si edhe planifikuar të orientuar drejt zhvillimit të saj.

Një plan produkt dhe proces; ky Plan Strategjik Zhvillimi si një mekanizëm institucional shërben për rritjen e mirëqenies të të gjithë banorëve të Komunës Guri i Zi, si edhe përcakton axhendën vendiore të zhvillimit të zonës. Ajo çka e bën të veçante është së ky plan nuk është thjesht një produkt, por mbi të gjitha një proçes, i cili mundëson formësimin e të ardhmes dhe adresimin e nevojave të komunitetit të Komunës Guri i Zi për të arritur qëllimet e tyre.
Plani evidenton politikat në nivel vendor dhe aktivitetet zhvilluese në të ardhmen, ndërkohe është i bazuar në nevojat, përparësitë dhe potencialet ekzistuese, të cilat janë evidentuar dhe diskutuar përgjatë një procesi të gjatë konsultash si me qytetarët ashtu edhe me grupin e punës të autoriteteve vendore.





Një plan vizionar; plani i Komunës Guri i Zi për të parën herë i përgjigjet ndjesisë vizionare të komunitetit të tij në lidhje me zhvillimin. Nisur nga fakti se konteksti shqiptar edhe pse duke njohur rëndësinë e eksperiencave në fushën e hartimit të dokumenteve strategjike si në nivelin rajonal ashtu dhe në atë kombëtar, përsëri ka munguar një ndërthurje vizionare të tyre për të shpjeguar se ku dhe si do të orientohen potencialet ekzistuese. Ky plan i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arrirë zhvillimit rajonal duke mundësuar zhvillimin në maksimum në të gjitha fushat përkatëse. Të gjitha veprimet e propozuara i shkojnë për shtat vizionit të dëshiruar në të ardhmen për këtë Komunë si një qendër shume e rëndësishme bujqësore për rajonin e veriut.

Një plan pragmatist; Plani Strategjik i Zhvillimit është konceptuar si një kontratë aksionesh midis autoriteteve dhe qytetareve, e cila krijon vizionin e përbashkët për zonën e Gurit të Zi, specifikon llojin, sasinë dhe cilësinë e zhvillimit të nevojshëm për përmbushjen e vizionit dhe kërkon të mbrojë me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Ndërkohe plani është i fokusuar të ndërtojë një kuadër pune si për të filluar ashtu dhe për të influencuar procesin e ndryshimit në Komunë, me qëllim mbështetjen e objektivave të gjëra ekonomike, sociale dhe mjedisore të komunitetit të Gurit të Zi.

Një plan i përditësuar dhe realist; ky dokument është i pajisur me një portofol hartash, të cilat do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të territorit, si edhe foto imazhe të ndryshme që pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe zhvillimin.

1.2 Nevoja për një Plan Strategjik Zhvillimi në Gurin e Zi

Qëllimi i dokumentit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi është të adresojë nevojat emergjente të evidentuara nga autoritetet e reja vendore të zgjedhura gjatë vitit që kaloi, në mënyre që të realizojnë një qeverisje të mirë urbane dhe të ravijëzojnë linjën strategjike për një zhvillim të qëndrueshëm.

Si pjesë e grupit të përbëre prej 8 Njësish të Qeverisjes Vendore partnere të IC Shqipëri në kuadër të programit PDZhL të ndërmarre në Rajonin e Veriut të Shqipërisë, Guri i Zi iu nënshtrua një vlerësimi teknik të detajuar, i cili u krye përpara ndërhyrjeve konkrete nëpërmjet zbatimit të PDZhL, vlerësim ky që u pasua me një seminar pune ku u qartësuan nevojat, kërkesat dhe prioritetet e Komunës.

Kuadri i përgjithshëm ligjor për përgatitjen e këtij dokumenti Strategjik Zhvillimi është ligji organik i pushtetit vendor, i cili përcakton, relativisht në vija të përgjithshme, se prej vitit 2001 Komunat dhe Bashkitë janë tërësisht përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të tyre ku përfshihet dhe fusha e zhvillimit ekonomik – vendor; konkretisht në (i) përgatitjen e programeve të zhvillimit ekonomik - vendor; dhe (ii) organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura përkatëse[1].

Nga ana tjetër, një nxitje / shtytje tjetër e rëndësishme në përforcim të nevojës për pajisjen e Komunës Guri i Zi me një dokument zhvillimi vjen gjithashtu edhe nga nismat, propozimet apo idetë e shprehura lidhur me zhvillimin strategjik në rajon dhe me gjerë. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky Plan të mund të analizojë më konkretisht këto ndikime të pritshme në zhvillimin e Gurit të Zi dhe të krijojë kushtet e përshtatshme të bashkëpunimit me to dhe përfitimit të ndërsjelle prej tyre, për të mbështetur objektivat më të gjera sociale, ekonomike dhe mjedisore të komunitetit.

Një evidentim dhe analizim i këtyre ndikimeve të mundshme dhe dokumenteve përkatës rajonalë bëhet në Kapitullin e Dytë të dokumentit, në nëntitullin Konteksti Rajonal.

1.3 Parimet dhe Objektivat mbi të cilat Mbështetet Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Dokumenti, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi mbështetet dhe ndjek parimet dhe objektivat si më poshtë vijon:

- **Strategjik**, plani përcakton fushat e veprimit afatgjate si dhe ndërhyrjet konkrete të cilat adresojnë nevojat emergjente të popullsisë apo grupeve të ndryshme të interesit, në një mënyre që të kombinojë gjithashtu edhe tendencat e zhvillimit në lidhje me të ardhmen e Komunës.
- **I thjeshtë dhe i kuptueshëm/lexueshëm**, duke prezantuar propozime konkrete dhe të prekshme për administratën vendore dhe në tërësi për nivelin e vendimmarrjes vendore. Po ashtu ky plan do të jetë i aksesueshem nga banorët vendas, grupe të ndryshme interesi të popullsisë, sipërmarrjet private vendase me qëllim për të mundësuar njohjen dhe praktikën e propozimeve të dala në të gjitha fushat e veprimit që mbulohen nga Komuna Guri i Zi.

[1] Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000, *Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.*

- **Fleksibël,** plani krijon hapësira për ndryshime të mundshme të bazuara në kriteret e nevojave që mund të dalin si pasojë e situatave të ndryshme të paparashikuara, zhvillimeve të reja dhe përmirësimeve të vazhdueshme që do të dalin si rezultat i punës së pushtetit vendor përgjatë zbatimit. Pa dyshim këto ndryshime do të realizohen duke iu referuar edhe kërkesave apo nevojave specifike sipas grupeve përkatëse të interesit.

- **I mundshëm/arritur**, Plani Strategjik i Zhvillimit është hartuar duke u bazuar në mundësitë reale të Komunës Guri i Zi si në kuptimin e këndvështrimit të burimeve njerëzore ashtu dhe ato financiare, ndërkohe pa munguar apo shmangur ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike të cilat edhe mund të shkojnë përtej kapaciteteve apo burimeve ekzistuese të Komunës.

- **Transparent**, në kuptimin se ky dokument në vetë llojin e tij është i hapur ndaj propozimeve të përfshira që kanë ardhur nga vetë komuniteti, biznesi apo grupe të tjera të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në Komunën e Gurit të Zi. Në këtë mënyrë plani nxit rritjen e besimit dhe përgjegjshmërinë përkundrejt pushtetit vendor përgjatë kohës së zbatimit të tij.

1.4 Struktura e Dokumentit

Mënyra me të cilën është hartuar Plani Strategjik i Zhvillimit është ruajtja e një strukture të thjeshte dhe të kuptueshme, në mënyrë që të përfshijë të gjithë grupet e synuara duke filluar që nga vetë administrata vendore, Këshilli i Komunës, grupet qytetare këshillimore, partnerë të ndryshëm që veprojnë në zonë, në Qarkun e Shkodrës si një njësi rajonale koordinuese, por mbi të gjitha t'i drejtohet donatorëve apo investitorëve kombëtarë dhe ndërkombëtare.

Dokumenti, Plani Strategjik i Zhvillimit është organizuar në katër kapituj kryesore duke zbatuar si më poshtë vijon:

KAPITULLI I PARË na jep një hyrje të kontekstit, rëndësisë dhe koncepteve kryesore mbi të cilat është bazuar dhe hartimi i tij.

KAPITULLI I DYTË, është një pasqyrë reale e situatës aktuale dhe profilit të Komunës Guri i Zi, bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informacionit ekzistues duke e paraqitur atë në këndvështrimin territorial, urban, social–ekonomik si dhe mjedisor. Si rezultat, në këtë kapitull, evidentohet kuadri i përgjithshëm i potencialeve, sfidave dhe tendencave para dhe pas viteve 90'.

KAPITULLI I TRETË vazhdon me një përshkrim të së ardhmes së Komunës për sa i përket vizionit dhe drejtimeve strategjike të propozuara me një shtrije e cila mbulon 5 fusha të rëndësishme. Të gjitha këto fusha ndiqen nga një zbërthim analitik i detajuar në nivel nismash dhe ndërhyrjesh konkrete me fokus zhvillimin ekonomik dhe social, menaxhimin e territorit, shërbimet publike dhe infrastrukturat përkatëse, qeverisjen e mirë me pjesëmarrje, dhe së fundmi po shumë e rëndësishme rritjen e burimeve financiare të nevojshme dhe të kërkuara për zbatimin e mëtejshëm të planit.

KAPITULLÍ I KATËRT është i angazhuar për të detajuar përcaktimet që burojnë nga kapitulli i tretë dhe për t'i përkthyer ato në plane konkrete veprimi të cilat do të zbatohen vit pas viti, bazuar në kritere të qarta kohore dhe në rëndësinë e ndikimit të secilës prej tyre. Në të njëjtën kohë këtu përfshihen propozimet mbi rregullimet e nevojshme si ligjore ashtu dhe institucionale, si edhe kuadri kohor i procesit të monitorim vlerësimit për çdo hap të ndjekur.

1.5 Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës

Rëndësia e dhëne në raport me marrjen në pronësi të planit nga të zgjedhurit lokalë si edhe nga publiku i gjerë është themelore për të lehtësuar gjithashtu edhe zbatimin me efektivitet të tij.

Që në fillimet e konceptimit të metodologjisë bazuar në procesin me pjesëmarrje e më pas në përmbajtjen e strukturuar si një dokument udhërrëfyes, të gjithë aktorët vendor u angazhuan për të ndjekur në vijim hap pas hapi procesin e zbatimit të tij në Komunën Guri i Zi, duke rritur në të njëjtën kohë shanset për transparencë.





Pamje të procesit të përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit në Komunën Guri i Zi

Pa dyshim që administrata e Komunës Guri i Zi mbetet aktori kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij plani në vijim, sidomos pasi ai vjen në një moment kyç për pushtetin vendor duke u shtrirë që prej fillimit në periudhën legjislative gjatë zgjedhjeve të fundit vendore që u mbajtën në vend.

Ndërkohë që vizioni i shprehur apo drejtimet strategjike i përkasin një afati kohor në terma më të gjata, plani i veprimeve të përshkruara në dokument është menduar të jetë më konçiz dhe t'i referohet një periudhe më të shkurtër kohore me një mundësi për shtrirje në të ardhmen.

Nga ana tjetër duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta në Shqipëri që priten të ndodhin, e po kështu në rajon e rrjedhimisht edhe në Gurin e Zi, mund të themi se rishikimi i Planit Strategjik të Zhvillimit është një subjekt reflektimi të vazhdueshëm. Ç'ka do të thotë së edhe udhëzimet mbi të do të duhen të konsolidohen apo rregullohen për t'iu përgjigjur kushteve të reja të zhvillimit që mund të pasojnë.



Kapitulli II

Përmbledhje e profilit – Komuna Guri i Zi

Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi ligjor dhe administrativ	Komunë
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	81.7 km²
4	Numri i qyteteve	0
5	Numri i fshatrave	11
6	Numri i banorëve	11, 800
7	Numri i familjeve	3000
8	Popullsia në gjendje fizike pune	55%
9	Buxheti vjetor - 2008	34,393,000 Lekë
10	Të ardhurat lokale të pritshme - 2008	8,000,000 Lekë
11	Numri i bizneseve private	850
12	Niveli i papunësisë	Nuk ka të dhëna të sakta
13	Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	67
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	Nuk ka të dhëna të sakta
15	Niveli i emigracionit	33%
16	Gjatësia totale e rrugëve	94 km
17	Numri i ndërmarrjeve publike	0
18	Numri i rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve	3
19	Numri i të punësuarve në Komunë	28
20	Numri i institucioneve parashkollore	5
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	7
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	1650
24	Numri i qendrave shëndetësore	10
25	Numri i spitaleve	0
26	Numri i qendrave të kështillimit	0
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Bujqësi & Blegtori
		Dyqane dhe njësi tregtare
		Njësi shërbimi
		Peshkim
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Strategjia e Zhvillimit Rajonal
30	Nevojat kryesore në infrastrukturë	Përmirësimi i rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve të fshatrave Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza Përmirësimi i rrjetit rrugor të Komunës Përmirësimi i hapësirave të brendshme të fshatrave Ndërtimi i pikës inxhinierike të depozitimit të mbetjeve në Komunë

Konteksti dhe Drejtimet Aktuale të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

2.1 Pozicioni Gjeografik dhe Karakteristikat Natyrore


Komuna Guri i Zi shtrihet në pjesën juglindore të qytetit të Shkodrës, përgjatë rrugës rajonale Shkodër- Vau i Dejës. Ajo kufizohet me komunat Postribë, Shllak, Bushat dhe Bërdicë. Koordinatat gjeografike të kufijve të Komunës janë:

Gjerësi gjeografike:

Veriore 42^{0}06'40"
Jugore 42^{0}00'00"

Gjatësi gjeografike:

Lindore 19^{0}41'30"
Perëndimore 19^{0}30'00"




Komuna Guri Zi përfshin në territorin e vet 11 fshatra, përkatësisht: Guri i Zi, Juban, Rragam, Vukatanë, Rrenc, Sheldi, Ganjollë, Gajtan, Mazrrek, Shpor, dhe Kuç. në këtë territor jeton një popullsi prej rreth 11 800 banorësh (3000 familje), në një siperfaqe rreth 81.7 Km$^{2.}$ Dendësia mesatare e popullsisë është 69 banorë për km2, por shpërndarja e saj në territor nuk është e balancuar në raport me shtrirjen gjeografike duke qenë një pjesë e mirë e popullsisë.

Harta e pozicionit gjeografik të Komunës Guri i Zi është përqendruar në fshatrat kodrinore dhe fushore në perëndim, dhe më pak në zonat lindore, përgjatë brigjeve të liqenit artificial.
Ndryshimet e dendësisë së banorëve në fshatrat kanë ardhur duke u theksuar sidomos pas viteve '90 me lëvizjen e lirë të njerëzve dhe vështirësitë e krijuara për përballimin e jetesës, në veçanti të mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve bazë.

Duke qenë e vendosur ndërmjet dy stacioneve hekurudhore Mjedë dhe Shkodër, Komuna përshkohet në drejtimin veriperëndim - juglindje nga linja hekurudhore veriore e Shqipërisë, e cila përshkon 6 fshatra perëndimore të Komunës me një përfshirje prej 2/3 të popullsisë totale.

Komuna zotëron pasuri të mëdha hidrike, kjo shpjegohet pasi pjesa më madhe e këtij kufiri të saj shtrihet në Liqenin Artificial të Vaut të Dejës, i cili ndodhet në lartësinë 74 m mbi nivelin e detit me thellësi maksimale 52 m



dhe ka një sipërfaqe totale prej 2470 Ha. Pjesë nën administrimin territorial të Komunës është 38 % ose 938 Ha. Në këtë liqen gjenden sasi të mëdha peshku të llojeve të ndryshme, ndërkohë që pozicioni i tij në këtë zonë ka ndikim pozitiv në zbutjen e klimës.



Pamje e fshatit Guri i Zi nga maja e Gajtanit

Komuna *ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 10.339 Ha. Kjo e ndarë:*

1. *Tokë bujqësore 2112 Ha, nga të cilat vetëm 1800 janë me vlere bujqësore.*
2. *Pyje 2139 Ha.*
3. *Kullota 789 Ha.*
4. *Troje 342 Ha.*
5. *Sipërfaqe rrugore 18 Ha.*
6. *Sipërfaqe ujore, zallishta, shkëmbinj etj 4939 ha.*

Komuna Guri i Zi ndodhet midis lartësive 8 – 630 m mbi nivelin e detit, kjo për shkak të thyerjes së relievit dhe ekzistencës së tipologjisë fushore, kodrinore dhe malore në të gjithë shtrirjen territoriale të saj.

Për këtë arsye identifikohen larmi të mëdha klimatike, tokësore, flore dhe faune, ndërtimi gjeologjik, relievi, hidrologjike etj.

Komuna Gur i Zi përfshihet në brezin e klimës mesdhetare me ndërthurje të klimës kontinentale.

Kështu ajo karakterizohet nga temperaturat mesatare të ajrit që lëvizin nga 14.1^{0}C deri në 16.7^{0}C duke arritur vlerat maksimale që luhaten prej 32.5^{0}C deri në 42^{0}C dhe ato minimale që luhaten prej – 1.1^{0}C deri në - 13^{0}C.

Sasia vjetore e reshjeve luhatet në 1266 – 2797 mm dhe presioni atmosferik nga 1010 – 1020 mb, lagështira mesatare relative e ajrit nga 60 – 76 %. Viti ka rreth 150 ditë me diell, 145 ditë me vranësirë të pjesshme dhe 70 ditë me reshje. Rrezatimi diellor arrin vlera të larta prej 130 kkal/cm^2 në vit, me vlera më të larta në rajone të veçanta. Mesatarja e matur në çdo 30 vjet për këtë zone tregon 2400 orë diellëzim vjetor.

Komuna dallohet për shumëllojshmërinë dhe cilësinë e burimeve të ujit të pijshëm, të cilat gjenden kryesisht në shpatet perëndimore dhe jugore të kodrave.

Komuna përshkohet në pjesën juglindore të saj nga rruga automobilistike nacionale Shkodër- Pukë-Kukës-Kosovë.
Toka bujqësore në këtë zonë është me tregues të mirë agronomike; mbi 80% e tokës potencialisht ndodhet nën ujë. Ndërkohë zona dallohet për këto karakteristika specifike

- Klimë të përshtatshme për ruajtjen dhe zhvillimin e shumë kulturave bimore e drurëve frutorë.
- Pasuri të shumta dhe cilësore të lëndëve inerte si rërë, zhavorr dhe lëndë të parë për prodhimin e tullave dhe të tjegullave.
- Sasi të mëdha të gurit dekorativ për ndërtim.
- Prania në fshatin Guri i Zi e një minerali me cilësi të mira zjarrduruese i përshtatshëm për t'u përdorur në industrinë e prodhimit të elektrodave. Mendohet të ketë edhe elemente radioaktive.

Kjo zonë mbart gjithashtu vlera të veçanta arkeologjike dhe historike. Ekzistenca e pikave të veçanta me vlera turistike të tilla si Kalaja e Gajtanit, Kalaja e Ganjollës, Ishulli i Shurdhahut (Sardës) etj, plotëson profilin e Komunës edhe në fushën e turizmit kulturor dhe historik. Këto pika turistike mbeten sidoqoftë subjekt për studim dhe vlerësim të mëtejshëm për të eksploruar mundësitë reale të shfrytëzimit të tyre në të ardhmen lidhur me këtë fushë.

2.2 Zhvillimi Rajonal

Zhvillimi i Komunës Guri i Zi padyshim që do të vlerësohet dhe rishikohet në funksion të progresit dhe ndryshimeve që priten të ndodhin në të gjithë rajonin e Shkodrës, pasi në asnjë moment Komuna nuk mund të konsiderohet e izoluar nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik dhe social. Në këtë logjikë Komuna duhet parë si pjesë e pandare dhe e rëndësishme e Rajonit verior të Shqipërisë edhe pjesë e funksionimit dhe bashkëpunimit të këtij Rajoni në lidhje me vendet e tjera fqinje si Mali i Zi dhe Kosova.

Ndërkohë, post vitet 90 kanë shënuar për Qarkun e Shkodrës një rënie të përgjithshme ekonomike, shoqëruar nga një apati e progresit dhe emancipimit të jetës publike dhe vlerave shoqërore e kulturore. Në të njëjtën kohë për shkak



të vijës politike të zhvilluar, ekziston një opinion në lidhje me mungesën e theksuar të vëmendjes ndaj zonës së veriut të Shqipërisë, në përgjithësi për sa i përket politikave ekonomike dhe sociale të ndjekura si edhe sigurimit të fondeve për ndërtimin e infrastrukturave dhe përmirësimin e shërbimeve bazë për popullsinë.



Figure 7.1 STRATEGIC ROADS & URBAN GROWTH AREAS

Në vitin 2005, Qarku Shkodër miratoi Strategjinë e Zhvillimit Rajonal Shkodër Lezhë. E bazuar në dinamikat specifike të rajonit, ritmet dhe tendencat e zhvillimeve demografike, ekonomike dhe sociale, ky dokument strategjik identifikon orientimet kryesore për përgatitjen e planeve strategjike të zhvillimit për njësitë e veçanta vendore, hartimin e projekteve të ndryshme në infrastrukturë dhe shërbime si dhe drejtimet e mundshme të zhvillimeve që çdo njësi mund të adresojë, duke u bazuar në kontekstin e vet si dhe në potencialet ekzistuese.

Strategjia Rajonale Shkodër Lezhë, i vë theksin konsolidimit të një rajoni policentrit, duke fuqizuar qendrën e saj, Shkodrën, por duke konsoliduar gjithashtu edhe bërthamat e vogla urbane në të gjithë rajonin. Sipas kësaj politike, ajo që duhet marrë në konsideratë në rastin e Gurit të Zi është krijimi i incentivave për konsolidimin e Komunës si një qendër rurale në periferi të qytetit të Shkodrës, duke minimizuar largimin e popullsisë drejt qytetit si dhe duke rritur sa më shumë përfitimet që kjo njësi e vogël vendore krijon nëpërmjet afërsisë territoriale me të.

Një nga komponentët kryesorë të propozuar në Strategjinë e Rajonit Shkodër Lezhë është zhvillimi bujqësor dhe blegtoral i territoreve bujqësore të fushëgropës së Shkodrës, nëpërmjet riorganizimit të fermave dhe rigjallërimit të infrastrukturave të nevojshme për to. Komuna Guri i Zi ka një fond të konsiderueshëm toke bujqësorë duke krijuar kështu premisat bazë për zbatimin e komponentit strategjik rajonal.

Gjithashtu e rëndësishme në Strategji Rajonale konsiderohet zhvillimi i llojeve të ndryshme të turizmit, si turizmi historik, turizmi natyror liqenor, agro-turizmi etj. Potencialet që disponon në këtë rast Komuna Guri i Zi bëjnë të mundur që ky komponent zhvillimi të jetë tepër relevant, duke identifikuar kështu nevojën për artikulimin e ndërhyrjeve të kujdesshme dhe strategjike.


Ajo që qëndron thelbësore në Strategjinë Rajonale dhe që duhet të merret në konsiderate në dokumentin në vijim të Komunës është përcaktimi së çdo njësi vendore duhet të veprojë maksimalisht në rritjen dhe konsolidimin e potencialeve ekzistuese që ajo disponon, duke shmangur ndërhyrjet e kushtueshme dhe të paplanifikuara qartë. Në rastin e Komunës Guri i Zi, është e rëndësishme të mbahet në konsiderate potenciali natyror dhe njerëzor që ajo disponon, duke e orientuar atë nëpërmjet përcaktimeve për transformimin dhe zhvillimin e territorit.

2.3 Të dhëna Historike

Zhvillimi historik i Komunës Guri i Zi daton shumë herët. Nga të dhënat e mbledhura janë pikërisht banorët e vërejtur në Shpellën e Gajtanit si më të hershëm në Shqipëri. Kjo periudhe përkon me kohën e paleolitit, rreth 1000 shekuj përpara. Pjese e zbulimeve dhe studimeve në këtë zonë janë fosilet e kafshëve prehistorike shumë të rralla, tashmë të zhdukura.

Në rrugë paralele janë zhvilluar zbulime të shumta arkeologjike, ku mund të përmendim dy prej tyre me vlerë të veçantë, të cilat konsistojnë në dy statuja të gjetura në fshatin Guri i Zi dhe Juban që datojnë shekujt 6-4 para Krishtit. Por duhet përmendur së ato sot gjenden në muzetë e Luvrit dhe Londrës dhe konsiderohen ndër vlerat më të rralla për Evropën.

Ndërkohë gjithashtu fshatrat Gajtan, Rrenc, Juban dhe Guri i Zi kanë patur zbulime të mbi 60 monedhave antike të 20 prerjeve të ndryshme gjatë viteve 300 – 161 para Krishtit.



Skicë, pozicionimi i zonave me interes për turizmin kulturor në lidhje me fshatrat e Komunës

2.4 Zhvillimi i Territorit të Komunës

Struktura hapësinore


Territori i Komunës Guri i Zi është i ndarë në mënyrë të dukshme nga vargu i kodrave që ndodhet midis lumit Drin si dhe liqenit artificial të Vaut të Dejës. Kodrat janë relativisht të zhveshura, të mbuluara me shkurre dhe kanë lartësi maksimale në piken e Shllimit, 54,7 m. Në pjesën perëndimore të Kodrave, deri në liqenin artificial ndodhen vendbanimet e Rragamit dhe Sheldisë. Këto fshatra kanë një dendësi tepër të rrallë ndërtesash ndërkohë që vitet e fundit, sipas të dhënave të autoriteteve lokale po evidentohet një tendencë për të ndërtuar banesa të reja në këtë zonë.

Zona ka gjelbërim të dendur, dhe paraqet një potencial të mirë për rritjen e kulturave bujqësore sidomos duhanit, ku kultura e Sheldisë është përmendur që herët për cilësinë e tij. Bregu i liqenit është i butë dhe ofron mundësi për aktivitete liqenore apo turizëm natyror.

Zona perëndimore e Komunës lidhet me pjesën tjetër nëpërmjet grykës së Përroit të Rragamit, nëpër të cilën kalon edhe rruga. Kjo e fundit është në gjendje jo të mirë fizike dhe administrata e Komunës e ka përfshirë në objektivat e saj të investimeve të rëndësisë parësore.

Në pjesën lindore të territorit të Komunës ndodhen fshatrat kryesorë të Komunës. Fshatrat më të mëdhenj të saj janë Guri i Zi, Juban dhe Vukatane, ndërkohë që fshatra më të vegjël janë Ganjolla, Kuç, Gajtan, Rrance. Me përjashtim të Vakatanës dhe të Kuçit, të gjithë fshatrat e tjerë shtrihen përgjatë rrugës Shkodër Mjedë, e cila është rrugë e asfaltuar por e dëmtuar në disa vende.

Në ndryshim nga vendbanimet lindore, fshatrat fushore të pjesës perëndimore të Komunës kanë një dendësi me të lartë banimi, veçojmë Gurin e Zi dhe Jubanin. Banesat janë të tipit rezidencial me oborr të brendshëm individual. Vitet e fundit në pjesën fushore të Komunës janë intensifikuar ndërtimet e banesave të reja, një pjesë e mirë e tyre janë në proces legalizimi. Në materialet hartografike paraqitet shtrirja e zonave urbane në territorin e Komunës. Shumica e ndërtimeve joformale, rreth 2000, janë të evidentuar në fshatrat Guri i Zi, Juban dhe Vukatanë. Asnjë nga fshatrat e Komunës nuk ka një plan urbanistik të qartë, autoritetet nuk dinë me saktësi kufijtë e lejuar të ndërtimit në secilin fshat, duke e kthyer planifikimin e territorit në një domosdoshmëri sipas autoriteteve vendore. Ndërkohë sipas të dhënave të Komunës, në këtë zone evidentohen rreth 342 Ha sipërfaqe urbane. Komuna nuk ka KRRT, dhe një ndër objektivat e saj



Tendencat e lëvizjes së popullsisë, brenda territorit të Komunës

është pikërisht ngritja e kësaj strukture të re, e cila do të mundësojë një menaxhim më të strukturuar të territoreve urbane në të ardhmen.

2.5 Të dhëna për Pronësinë e Tokës

Gjendja kadastrale e tokës merret ajo e datës 31.12.1990. Në këtë pasqyrim përfshihen shumë toka pemëtore vresht dhe ullishte, pjesa më e madhe e të cilave aktualisht është tjetërsuar në toka pyje ose kullota. Në të gjithë pjesën fushore, në çdo parcelë është lënë rruga me një gjatësi 4 m, e cila nuk përfshihet në sipërfaqen ndarëse, si e tillë ka rreth 2 % tokë më pak të ndarë realisht. (p.sh. në një parcelë 600x200 m është lënë rrugë kalimi në sipërfaqe 600x4 m).

- Praktikisht në tokë arë janë të regjistruara në kadastër edhe "tokat e reja" të hapura në vitet e socializmit, pjesa më e madhe e të cilave janë refuzuar pasi janë joproduktive dhe shumë larg qendrave të banimit.
- Me ndryshimet demografike shumë sipërfaqe toke janë kthyer në troje.
- Ndarja e tokës, plotësimi tapive dhe shpërndarja e tyre bëhet pas përfundimit të procesit në gjithë fshatin. Konkretisht në dy fshatra nuk është përfunduar procesi dhe nuk janë plotësuar fare tapitë e tokës.
- Marrja e tokës në përdorim konsiderohet e ligjshme nëse marrësi e ka nënshkruar aktin përkatës. Pothuaj në të gjithë rastet nuk është kryer ky nënshkrim. Megjithatë për momentin është konsideruar akt i rregullt.
- Nuk mund të ketë reformë të tokës pa dokumentimin e kalimit në pronësi të rregullt të tokës nga zyra e Regjistrimit të Pasurisë. Ky proces për Komunën Guri Zi nuk ka filluar fare në tre fshatrat bazë të Komunës (Guri Zi, Juban dhe Vukatanë) që kanë mbi 50 % të popullsisë dhe mbi 50 % të tokës arë në shkallë Komune.
- Ka akoma probleme të pazgjidhura ndërmjet kufijve midis fshatrave si ndërmjet fshatit Kuç – Guri Zi, Vukatanë – Guri Zi etj.

2.6 Profili Ekonomik i Komunës

Aktivitetet ekonomike ekzistuese

Sipas të dhënave të Komunës Guri i Zi, në territorin e saj funksionojnë rreth 850 aktivitete private. Tabela më poshtë paraqet në mënyrë më të detajuar numrin e aktiviteteve fitimprurëse në këtë zonë

Aktivitetet	Veprimtaria	Nr. i njësive (familje)
Bujqësi	Sera	32
	Vresht-pemëtore	56
	Furra Buke	2
	Bimë arash	80
	Perime	75
	Duhan	210
Blegtori	Prodhim & shpërndarje qumështi	180
	Prodhim mishi	5
	Baxho	2
Artizanat	Tezgjah	73
	Përpunim druri	2
Biznese	Firma ndërtimi	3
	Njësi shitje me pakicë	33
	Njësi prodhimi	16
	Njësi shërbimi	25
	Bar-bufe	18
	Shfrytëzim inertesh	2
Transporte	Transport pasagjerësh	32
	Transport mallrash	12
Gjithsej		858

Sipas të dhënave të marra, Komuna disponon rreth 2112 Ha tokë bujqësore, ndërkohë që vetëm 1800 Ha janë të punueshme. Për shkak të pozicionit gjeografik, të gjitha tokat janë të ujitshme ndërkohë që nga autoritetet është shprehur nevoja për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve ujitëse dhe sidomos atyre kulluese. Komuna disponon gjithashtu rreth 2140 Ha pyje si dhe 790 Ha kullotë.

Shpërndarja e tokës bujqësorë sipas pozicionimit territorial

Fushë	1654 ha
Kodër	163 ha
Mal	235 ha

Aktivitetet ekonomike bujqësore janë të fokusuar në funksionimin e fermave të vogla individuale dhe ekonomive familjare. Vitet e fundit vihet re një rritje e prodhimit bujqësor nga ana e fermerëve të vegjël por përsëri problem mbetet mungesa e kapaciteteve financiare dhe teknike për rritjen e rendimentit. Prodhimet janë misër, domate, perime të stinës, foragjere, etj, dhe shumica e tyre tregtohen në qytetin e Shkodrës. Prodhuesit e vegjël ankohen për pasigurinë që ofron një sistem i tille tregtimi, i cili e bën tepër të vështire ndërmarrjen e iniciativave për organizimin e fermave më të mëdha si dhe të rritjes së prodhimit bujqësor.

Në territorin e Komunës gjendet edhe një fabrikë e prodhimit të pjesëve të këmbimit për hidrocentralet. Tashmë fabrika është pjesërisht në punë, nga disa firma të ndryshme private.

2.7 Financat e Komunës

Komuna Gur i Zi ka të ardhura relativisht të ulëta. Situata financiare në këtë Komunë, ashtu si edhe në shumë njësi të tjera vendore të vogla mbështetet kryesisht në grantin vjetor të qeverisë.
Në tabelën me poshtë paraqiten shifrat e grantit të pakushtëzuar në vitet e fundit (në mijë lekë)

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Granti	15,715		26,558	25,885	26,393

Siç vihet re, në tre vitet e fundit ka një stabilizim të shifrës së grantit të pakushtëzuar që vjen nga qeveria qendrore. Ndërkohë që të ardhurat vendore të Komunës kanë qenë si më poshtë:

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Të ardhurat	2,496	3,795	4,625	5,527	8,000

Për vitin 2008 janë planifikuar të grumbullohen rreth 8 milion lekë nga të ardhurat vendore. Burimi kryesor i tyre janë tarifat e shërbimeve që ofron Komuna, taksat e biznesit, si dhe taksat e pronësisë.

Sipas të dhënave të administratës është e nevojshme që të rritet sasia e të ardhurave nga taksa e pronësisë, e cila duhet të përbëjë edhe bllokun më të madh të të ardhurave të kësaj të fundit.

2.8 Mundësitë për Zhvillim Ekonomik

Duke u bazuar në të dhënat e përftuara nga administrata e Komunës si dhe nga kontributi i Grupit të Qytetareve të angazhuar në përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit, janë evidentuar:

Mundësitë për zhvillimin e biznesit të vogël

- Krijimi i kushteve për evidentimin, legalizimin dhe licencimin e gjithë subjekteve private që operojnë në Komunën Guri i Zi.
- Nxitja, stimulimi dhe krijimi i kushteve favorizuese për aktivitetet prodhuese bujqësore dhe blegtorale në të gjithë fshatrat e Komunës.
- Asistencë teknike e kualifikuar në nxjerrjen e bilancit vjetor.
- Punë më e studiuar për përcaktimin me të saktë dhe real të vlerës së tatimit ndaj biznesit vendor në Komunë.

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë

Sipas zonave ku shtrihet Komuna, përparësitë do të orientohen:

- Në zonën fushore:
  - *Zhvillimi i perimtarisë në sera dhe fushë të hapur.*
  - *Zhvillimi i blegtorisë, sidomos lopa e qumështit.*
- Në zonën kodrinore:
  - *Zhvillimi i vreshtarisë dhe frutikulturës*
  - *Zhvillimi i blegtorisë (qumështi dhe mishi)*
- Në zonën malore:
  - *Kultura e duhanit (Ragam, Sheldi)*
  - *Zhvillimi i vreshtarisë (Masër, Shpor)*
  - *Bagëtia e imët*
  - *Bletaria*

Në shërbim të kësaj, drejtimet e punës duhet të jenë:

- Rritja e sipërfaqes së serave, futja e teknologjisë së përparuar si ujitja me pika, ngrohja artificiale, plehërimi kristalor, mulçerimi etj.
- Krijimi i mundësive për eksport të prodhimeve bujqësore-blegtorale.
- Përmirësimi racor dhe i strukturës së tufave në blegtori. Inseminimi artificial me raca superiore e të pastra në të gjithë territorin e Komunës.
- Shërbim profilaktik i rregullt e cilësor.
- Përmirësime të strukturës së ushqimeve sipas parametrave shkencore.
- Nxitja e fermerëve për të krijuar vreshta të reja. Ngritja e një pike për prodhim të përqendruar dhe nën kontrollin fito - sanitar të fidanëve cilësorë mbi copa antifilokserike dhe një pike tjetër për prodhim bandierash.





Zhvillim i industrisë përpunuese:

- Ndërtimi i një impianti për përpunimin e duhanit tradicional "Sheldia" në fshatin Rragam.
- Ndërtimi i një linje prodhimi të verës dhe mushtit në fshatin Guri i Zi me ambalazh cilësor dhe serioz.
- Ndërtim punishteje për përpunim frutash si salcë, komposto, reçel etj në fshatin Juban.
- Ndërtimi i baxhove për prodhimet e qumështit.

Zhvillimi i turizmit

Duke qenë rajon afër qytetit të Shkodrës, me pastërti ajri dhe uji, me pasuri të shumta ujore dhe pyjore si dhe me vlera arkeologjike, merr përparësi:

- Zhvillimi i turizmit liqenor:

Në plan të parë mbetet ishulli i Shurdhahut i cili ka nevojë për rikonstruksionin e objekteve të kultit.

- Pjesa veriore e ishullit mund të pyllëzohet me dru cilësor si bredh, pishë, panjë. Ishulli do të merret nën juridiksionin e përbashkët të kishës katolike dhe institutit të monumenteve të kulturës me marrëveshje bashkëpunimi institucional

Evidentohen gjithashtu mundësi zhvillimi të turizmit në kodrat dhe brigjet rreth ishullit si në Vjerdhe, Shpor, Mazrek. Gjithashtu duhet marrë në konsideratë edhe mundësia e zhvillimit të turizmit pyjor.





Zhvillimi i pyjeve
Për shkak të karakteristikave natyrore, Komuna Guri i Zi ka potencial për rritjen dhe mbarështimin e pyjeve. Projekti tashmë i miratuar i Bankës Botërore për Komunën Guri i zi krijon baza reale për një gjë të tille. Kjo do të kërkojë kryerjen e shërbimeve agroteknike të sipërfaqeve të pyjeve ekzistuese, si dhe pyllëzimet e reja në kodrat dhe shpatet e zhveshura perëndimore të Komunës.

2.10 Punësimi

Punësimi social:
Këtu kemi patur parasysh atë kategori të punësuarish që kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike dhe kanë kaluar në punë publike sipas ligjit përkatës. Në Komunën Guri i Zi janë të evidentuar rreth 50 individë të punësuar në punë të tilla në shërbim të komunitetit si shëndetësi, arsim, në administratën vendore etj.

Punësimi
Në tabelën më poshtë evidentohen numri i të punësuarve në Komunë

Nr	Aktivitetet	Nr i të punësuarve	Nga këto: Gra
1	Bujqësi	871	427
2	Blegtori	376	189
3	Artizanat	93	83
4	Biznese	236	101
5	Transporte	44	0
6	Administrate	78	46
Gjithsej		**1698**	**846**
Emigracion		600	260

Edhe pse shifrat datojnë pak vite përpara, situata në lidhje me mundësitë reale për punësim dhe hapësirat e nevojshme nuk janë në nivelin e përmbushjes së nevojave qytetare. Reflektimi ndaj shifrës së lartë të

emigracionit është një reagim ndaj nivelit të ulet të punësimit në vend dhe detyrimit për t'u larguar me qëllim sigurimin e të ardhurave, por në të njëjtën kohë shërben për të kuptuar së të ardhurat nga emigracioni zënë një peshë të konsiderueshme për përballimin e jetesës dhe krijimin e mundësive për investime të vogla, kryesisht në sektorin e shërbimeve.

2.11 Shërbimet Publike

Një nga detyrat më të rëndësishme të Komunës Guri i Zi mbetet administrimi i shërbimeve dhe ofrimi i tyre me eficencë dhe efikasitet për qytetarët. Në kushtet e realizimit të procesit të decentralizimit në Shqipëri, një sfidë e re dhe e vështirë paraqitet për Komunën gjatë kalimit të më shumë kompetencave dhe përgjegjësive sidomos në lidhje me shërbimet, në kohën kur buxheti aktual i saj nuk është në gjendje të përballojë sigurimin e plotë të tyre. Në funksion të sa më sipër shërbimet për të cilat është përgjegjëse Komuna Guri i Zi në nivelin e njësisë së qeverisjes vendore, janë si më poshtë vijon:

- ❖ arsimi parashkollor; kujdesi shëndetësor; furnizimi me ujë; administrimi i tokës dhe burimeve ujore; grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave urbane; mbrojtja e vlerave kulturore vendore; administrimi i pronave vendore; etj.

2.12 Furnizimi me Ujë

Komuna Guri i Zi edhe pse ka përfshirë në inventarin e pronave publike sistemin e furnizimit me ujë, ai ende nuk është nën përgjegjësinë zyrtare të kësaj Komunë për administrim.

Në Komunën Guri i Zi funksionon vetëm rrjeti i furnizimit me ujë për fshatrat Guri i Zi, Juban dhe Rragam, ndërkohë që në fshatrat e tjerë, furnizimi i popullatës kryhet nëpërmjet puseve individuale. Duhet thënë që edhe në fshatrat Juban dhe Rragam, rrjeti i ujësjellësit është thuajse jashtë funksionit, ndërkohë që në vitin 2006 është projektuar rrjeti i ri për fshatin Guri i Zi. Problematik mbetet për këtë të fundit ndryshimi i burimit të ujit, i cili aktualisht është i vendosur në zonë fushore dhe që funksionon me stacion pompimi. Kjo gjë shkakton probleme në furnizim për shkak të defekteve apo të mungesës së energjisë elektrike.

Për furnizimin me ujë ekzistojnë 2 puse të cilët kanë kapacitete të ulëta prurëse. Gjithashtu ekzistojnë 2 depo uji.

Duhet theksuar së e gjithë zona në studim ka mundësi për furnizim të plotë me ujë për shkak të sasisë së madhe të ujërave nëntokësore.

Nevojat kryesore për ndërhyrje në ujësjellës

- Projekte teknike për rehabilitimin e ujësjellësve në Juban dhe Rragam
- Ndërtim i ujësjellësve për fshatrat e tjerë të Komunës: Ganjollë, Vukatanë, Rrancë, Kuç, Mazrek.
- Instalimi i matësve të ujit në fshatin Guri i Zi

2.13 Kanalizimet e Ujërave të Zeza

Në të gjithë territorin e Komunës Guri i Zi mungojnë fare kanalizimet e ujërave të zeza. Pjesa më e madhe e ujërave derdhen në kanale të hapura ndërsa një pjesë e banorëve përdorin gropa septike. Lidhur me këtë çështje duhet përmendur rreziku për ndotjen e ujërave nëntokësore dhe mbitokësore si dhe rreziku për shëndetin e banorëve të Komunës.





2.14 Infrastruktura Rrugore

Në territorin e Komunës Guri i Zi ekzistojnë rreth 94 km rruge rurale. Ndërkohë që ka vetëm një segment të rrugës nacionale, dhe asnjë segment rruge rajonale. Ndërmarrja e Rrugëve Rurale nuk ka asnjë aks rrugor të Komunës për të mirëmbajtur.
Rruga kryesore që përshkon Komunën është rruga Mjedë Shkodër, e cila ka një profil tërthor prej 7 metrash. Me përjashtim të segmenteve shumë të vogla, rruga nuk ka trotuare; është e asfaltuar, por në shumë vende ka nevojë për rehabilitim. Thuajse në të gjithë profilin gjatësor rruga nuk ka tabela për emrat e fshatrave.





Në vitin 2006 Komuna ka investuar rreth 4 milionë Lekë për asfaltimin e rreth 800 m rrugëve rurale. Sipas të dhënave të Komunës, rreth 90 km rruge rurale kanë nevojë për asfaltim dhe mirëmbajtje.

Zona e fshatrave malore Mazrrek dhe Shpor lidhen me qendrën e Komunës dhe rrugën kryesore nëpërmjet liqenit artificial. Në raste erërash ai bëhet i pakalueshëm për njerëzit dhe mallrat.

Vlen të theksohet puna e mirë e bërë nga institucionet fetare si Kisha Katolike në riparimin e aksit rrugor brenda fshatit Juban dhe atë Rragam-Sheldi si dhe në ndërmjetësimin me forcat e NATO-s në Shqipëri për rehabilitimin dhe shtrimin me zhavorr të rrugës Guri Zi – Rragam.



Skica Skematike te propozuara per nderhyrje ne rrjetin rrugor, ne varesi te zonave te banuara apo rurale.

2.15 Shërbime të Tjera

Ndriçimi rrugor
Ndriçimi rrugor në Komunë mbulon vetëm një pjesë të fshatrave Guri i Zi dhe Juban, ndërkohë që nevojat janë krahasimisht të larta edhe për akset rrugore Rrenc-Ganjoll si dhe në qendrat e fshatrave, në sheshe e objekte sociale, etj.

Dekori
Komuna Guri i Zi nuk ofron këtë shërbim, për shkak të mundësive të pakta financiare që disponon

Transporti publik
Aktualisht, në Komunën Guri i Zi, transporti kryhet nëpërmjet operatorëve privatë. Sipas të dhënave të Komunës janë të licencuar 8 minibusë të cilët lidhin fshatrat e ndryshëm të Komunës apo vete Komunën me Shkodrën. Vetë Komuna si institucion nuk ka mundësi që të ofrojë shërbim transporti urban. Problematikat në këtë drejtim mbeten frekuencat e lëvizjes së mjeteve si dhe mungesa e pikave të përcaktuara të ndalimit të minibusëve.

2.16 Mbeturinat Urbane

Komuna Guri i Zi aktualisht kryen grumbullimin dhe depozitimin e mbeturinave në një shtrirje vetëm në 4 nga 11 fshatra që janë pjesë administrative e saj. Kjo për arsye të përqendrimit më të larte të popullsisë në këto zona dhe pamundësisë për të përballuar mbulimin e shërbimit në zonat me popullsi shumë të vogël ku kostot nuk mund të mbulohen nga tarifa.

Përveç shërbimit të ofruar për familjet, Komuna ofron shërbim dhe në zonat ku janë shkollat si dhe bizneset në zonë, me frekuencë një here në javë, e cila zakonisht rritet gjatë sezonit të verës. Komuna ka përcaktuar tarifat për mbeturinat për familjet dhe për bizneset, por në fakt vetëm këto të fundit paguajnë duke vështirësuar rritjen e efiçiencës së shërbimit.

Shërbimi i grumbullimit i është kontraktuar një firme private e cila bën grumbullimin dhe depozitimin e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve bëhet me mjet të hapur ndërkohë që në të gjithë territorin e shërbyer janë të vendosur 15 kazanë metalikë.

Problem i mprehtë për Komunën mbetet vend depozitimi i mbeturinave, mungesa e të cilit ka shkaktuar dhe vazhdon të krijojë probleme të ndotjes së mjedisit. Komuna përdor për depozitimin e mbeturinave vendgroposjen e Shkodrës e cila ndodhet brenda territorit të Gurit të Zi.

Për zgjidhjen e këtij problemi është parashtruar mundësia e një venddepozitimi sanitar rajonal (landfill), nga i cili të mund të përfitojnë të paktën disa njësi qeverisjeje vendore, Shkodra, Guri i Zi, Vau-Dejes dhe Dajçi. Por një variant i tillë do të kërkonte një rritje të konsiderueshme të tarifës së grumbullimit gjë që edhe në nivelin ekzistues grumbullohet shumë pak

Në këtë kuadër, përcaktohet nevoja që Plani Strategjik i Zhvillimit lokal të adresojë këtë çështje duke propozuar një skemë të mirëfillte menaxhimi të grumbullimit, transportit dhe venddepozitimit të mbeturinave urbane, duke u bazuar në shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve dhe të bashkëpunimit por edhe në reduktimin e kostove për realizimin e tij.

2.17 Demografia

Popullsia e komunës i përket dy besimeve fetare: Katolike (rreth 2/3) dhe Myslimane (rreth 1/3) të cilat jetojnë në harmoni dhe tolerancë ndërmjet tyre.

Në tabelën më poshtë jepet numri i popullsisë së fshatrave të Komunës midis viteve 2004 – 2007 (nga të dhënat e gjendjes civile)

Nr	Fshatrat	*2004*	*2005*	*2006*	*2007*
1	**Gur i Zi**	2449	2456	2497	2502
2	**Juban**	2366	2370	2377	2380
3	**Vukatanë**	1141	1126	1099	1083
4	**Ganjollë**	528	541	558	558
5	**Kuç**	593	593	596	596
6	**Rrencë**	1002	1034	1097	1098
7	**Gajtan**	356	357	360	368
8	**Rragam**	1333	1300	1291	1287
9	**Sheldi**	1019	980	957	958
10	**Mazrek Shpor**	906	892	813	810

Nga të dhënat e tabelës evidentohet së në përgjithësi, ka një rritje të ulet të popullsisë së Komunës. Ajo që duket qartë është ulja graduale e popullsisë në zonën lindore të Komunës dhe përkatësisht në fshatrat Rragam, Mazrek dhe Sheldi, ndërkohë që fshatrat në perëndim po përjetojnë një rritje të ngadaltë por të vazhdueshme. Kjo rritje implikon politika të nevojshme nga ana e autoriteteve për të adresuar nevojat në të ardhmen për strehim, shërbime dhe infrastrukture.

2.18 Zhvillimi Social

Aktualisht aktiviteti shoqëror dhe kulturor në Komunën Guri i Zi është në nivele të ulëta. Pasqyra e përgjithshme e jetës shoqërore reflekton megjithatë një apati të theksuar në lidhje me jetën publike dhe kryerja e aktiviteteve nuk ka një axhendë të udhëhequr apo të organizuar për komunitetin. Në këtë kuadër, nismat e Komunës Guri i Zi do të realizojnë jo vetëm rritjen e cilësisë së shërbimeve, por do të lehtësojnë proceset që lidhen me jetën me të gjerë sociale dhe kulturore të këtij komuniteti. Të gjitha këto nisma shërbejnë jo vetëm për të adresuar nevojat emergjente për plotësimin dhe përmirësimin e shërbimeve, por mbi të gjitha për synuar një objektiv me afatgjatë dhe vizionar, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mirëqenies së përgjithshme të komunitetit vendas.

Arsimi dhe edukimi

Sistemi i arsimit në Shqipëri është i organizuar në mënyrë të tillë, ku sipas ligjit në fuqi, Komuna Guri i Zi është pjesërisht përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi, por varësia e këtij të fundit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria Arsimore Shkodër ndikon në cilësinë e tij. Kjo kushtëzon në masë shumë të madhe koordinimin për sigurimin e një shërbimi më efecient dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave dhe detyrimeve që lidhen me edukimin e gjeneratës së re.

Shkolla e parë në territorin e Komunës Gur i Zi dokumentohet të jetë hapur në vitin 1775 në Sheldi. Më vonë, rreth vitit 1880 ndeshet shkollë edhe në fshatin Juban. Në të gjithë këto raste këto shkolla janë hapur nga klerikë katolikë. Edhe pse historiku për arsimimin daton shume herët në këtë zonë, mund të themi së situata që paraqitet në ditët e sotme është larg standardeve të nevojshme dhe përgjigjes ndaj komunitetit për një shkollim sa me cilësor të fëmijëve të tyre.

Sipas vlerësimit teknik të kryer në vitin 2006, në Komunën Guri i Zi janë evidentuar 5 kopshte fëmijësh (138 fëmijë), 9 shkolla fillore 1639 nxënës) si edhe 1 shkollë fillore dhe 9-vjeçare private në fshatin Mazrek.







Aktualisht janë 9 shkolla, nga të cilat njëra fillore, 7 nëntëvjeçare dhe një e mesme, ku përfshihen niveli parashkollor, fillor, tetëvjeçar dhe i mesëm. Në tri shkolla, në Mazrek Shpor dhe Sheldi, mësimi zhvillohet në klasa kolektive. Gjendja e mjediseve shkollore është përgjithësisht e mirë. Në 6 shkolla kemi mjedise tepër komode, të mirëmbajtura dhe të investuara vitet e fundit. Në shkollën në fshatin Vukatanë kushtet janë relativisht të mira, ambientet janë të pamjaftueshme dhe mësimi zhvillohet me turne. Aktualisht në fshatin Mazrek nuk ka ambient për të zhvilluar mësim, por si shkollë është adoptuar një shtëpi banimi e cila është marrë me qera nga ana e pushtetit vendor, gjë që edhe rëndon buxhetin e kësaj Komune për arsimin.

Mundësitë për shkollim nuk janë në standardin e kërkuar, pasi nxënësit mësojnë me klasa të kombinuara dhe kushtet fizike të ndërtesave nuk janë në gjendjen e dëshiruar për të zhvilluar një proces normal dhe cilësor mësimdhënieje. Mungon baza e materialeve didaktike dhe sidomos laboratorëve (kjo situate megjithatë është e vlefshme njësoj edhe për rajonin dhe vendin në përgjithësi) dhe shpeshherë karakterizohet nga një numër nxënësish për klasë që e tejkalon standardin e vendosur. Kështu nga standardi 20-30 nxënës për klasë, në kushte të caktuara numri mund të arrijë dhe 45-50 nxënës për klasë.

Si nevoja të Komunës të evidentuara do të ishin:

- Blerja e një ndërtese dhe përshtatja e saj në shkollë në fshatin Mazrek, duke e rindërtuar (rikonstruktuar) dhe mobiluar
- Ndërtimi i një shkolle të re në fshatin Sheldi
- Shtesë shkolle (dyfishin e kapacitetit) në fshatin Vukatanë
- Plotësimi i shkollave me laboratorë, kabinete, biblioteka

Zhvillimi dhe çështja e integrimit gjinor

Në raport me situatën e grave në Komunën Guri i Zi, mund të thuhet se evidentohet një numër i ulet i grave të punësuara. Ndërkohë që në aspektin e edukimit, për shkak edhe të politikave në nivel kombëtar, vihet re një balancim i raportit midis



vajzave dhe djemve në të dy shkollat e Gurit të Zi. Për fat të keq nuk është e njëjta situatë për sa i përket punësimit të vajzave dhe grave.

Gjithashtu, problem mbetet përfshirja e grave në vendimmarrje. Një tregues me vlerë të përmendet këtu është së në Këshillin Vendor të Komunës Guri i Zi, nga 17 anëtarë, ka vetëm 2 femra.

Në propozimet e tij Plani i Aktiviteteve duhet të përmbajë veprime të cilat do të mundësojnë punësimin e grave dhe të vajzave në Komunën Guri i Zi. Vetë administrata e Komunës duhet të marrë në konsideratë gjetjen e mundësive për rritjen e kapaciteteve profesionale të ndryshme të grave dhe vajzave në të.

Shëndeti publik

Për sa i përket çështjes së kujdesit shëndetësor për komunitetin, ai është padyshim një nga nevojat e ndjeshme, që kërkon përgjegjshmëri të lartë dhe adresim të shpejtë të kërkesave të banorëve. Shëndeti publik në fakt lidhet jo vetëm me shërbimet mjekësore, por sidomos me kualifikimin e lartë të punonjësve të shëndetësisë dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës përkatëse.

Aktualisht në Komunë ka 10 Qendra Shëndetësore, nga të cilat njëra e ndërtuar nga kultet fetare. Shërbejnë 4 mjekë dhe 14 infermiere – mami. Nuk ka spitale dhe as shtëpi lindjeje. Ka vetë dy pika furnizimi me ilaçe. Nevojat janë tepër emergjente për ndërtimin e të paktën tre qendrave shëndetësore në fshatrat Vukatanë, Rrenc dhe Kuç, ku popullsia vjen gjithnjë në rritje dhe ka probleme.

Mund të thuhet së Komuna Guri i Zi ka në linja të përgjithshme një shtrirje të gjerë të shërbimit shëndetësor në të gjithë fshatrat e saj, me ndërtimin e një qendre shëndetësore për çdo fshat të Komunës.

Megjithatë, nevojat në rritje të banorëve për përmirësimin e këtij shërbimi padyshim që janë në konsideratë të planit të zhvillimit për këtë fushë me fokus:

- Shërbimi shëndetësor të garantohet nëpërmjet rritjes së kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies, shërbimit profilaktik dhe edukimit etj.

- Shërbimi mjekësor të mbulohet me mjekë në fshatra kryesore dhe infermiere-mami në çdo fshat.
- Do ketë ndërtim qendrash të reja shëndetësore në fshatrat Rrenc dhe Vukatanë, të cilat të jenë të parametrave bashkëkohorë.
- Shërbimi farmaceutik të jetë i licencuar, të zotërojë disiplinë profesionale dhe të ketë mbikëqyrjen ligjore për çdo shkelje nga strukturat përkatëse shtetërore
- Futja e shërbimit të përhershëm stomatologjik në shkolla dhe kontrolli periodik ortopedik.

Aktivitetet kulturore / Aktivitete sportive dhe të kohës së lirë

Sigurimi dhe mirëmbajtja e mjediseve arsimore dhe atyre argëtuese dhe të kohës së lirë është një detyrë e Komunës. Në këtë drejtim, Komuna vlerëson së me përgatitjen e një Plani Strategjik të Zhvillimit për Komunën e Gurit të Zi, do të jetë e mundur të përcaktohet ndërtimi dhe zgjerimi i mjediseve të tjera sociale të reja, si dhe të hartohet një plan pune për ngritjen e tyre. Aktualisht brenda territorit të Komunës është e vendosur një fushë sporti komunale si edhe një fushe futbolli e vogël, e cila është nën administrim privat

Edhe pse në Gurin e Zi ka numër të konsiderueshëm të kafeneve/bareve etj, aktivitetet argëtuese dhe kulturore ende nuk kanë një formë të organizuar. Komuna gjatë vitit 2006-2007 është angazhuar në projekt-idenë për ndërtimin e një qendre komunitare brenda territorit të ndërtesës ku është e vendosur ajo. Qendra është një nevojë e domosdoshme për përmbushjen e kërkesave të komunitetit për një jetë komunitare me aktivitete të larmishme kulturore dhe sidomos për adresimin e grupeve si gratë, të rinjtë etj, në ofrimin e ambienteve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë si dhe shërbimeve përkatëse.

Aktualisht puna për ndërtimin e kësaj qendre ka filluar dhe ajo pritet të përfundojë në Korrik të vitit 2008. Sipas koncept-idesë kjo qendër është ideuar në formën e një salle të rikonstruktuar tërësisht dhe e pajisur me tavolina pune e karrige me kapacitet për 40 vetë, kompjuter, telefon, faks, e-mail, salle interneti, video dhe televizor si dhe fotokopje.

Një sallë e tillë do shërbejë për:
- Sallë mbledhjesh, organizim tryezash të rrumbullakëta, forumesh etj.
- Qendër për argëtimin e të rinjve në mënyre të kulturuar.
- Qendër e vazhdueshme trajnimi të banorëve të komunitetit në drejtime të ndryshme.
- Qendër takimi dhe zhvillimi debatesh intelektuale për problemet e zhvillimit shoqëror dhe të komunitetit.
- Qendër grumbullimi dhe shpërndarje informacioni nëpërmjet abonimit në internet, klasifikimit dhe seleksionimi i tij sipas interesave të banorëve të komunitetit dhe publikimi i tij nëpërmjet buletineve tekniko-shkencore, fletëpalosjeve etj.
- Si bibliotekë dhe qendër studimore nëpërmjet pajisjes me libra të rëndësishëm, kryesisht të sferës shkencore, sociale, historike, kulturore dhe profesionale.
- Qendër koordinimi mes shoqatave joqeveritare që kanë aktivitet në Komunë.

Kjo qendër do të përdoret edhe për

- Botimin e një gazete vendore periodike me karakter informativ, kulturor dhe social.
- Ngritjen e muzeut të Komunës.
- Hapje ekspozitash të ndryshme.
- Realizimin e anketimeve të ndryshme lokale e qendrore.
- Do të organizohen seminare teorike dhe praktike me të zgjedhur të pushtetit vendor për problemet e njohjes së kuadrit ligjor të qeverisjes vendore, menaxhimi i pronave, buxheti dhe financat, shërbimet publike ndaj komunitetit , problemet sociale dhe mbrojtjes shoqërore, arsimimi, shëndeti publik, mbrojtja e mjedisit etj.
- Çdo vit do të organizohet zhvillimi i një ankete me përfaqësues nga çdo fshat i Komunës, jo me pak së 2% e popullsisë së fshatit dhe mbi 20 të anketuar nga çdo fshat . Analizimi dhe përpunimi i tyre do t'i shërbejë përmirësimit të qeverisjes dhe përcaktimit të përparësive të punës.

Mjedisi i shëndetshëm

Shtimi i aktivitetit ekonomik privat dhe individual pas vitit 1990 në vend e ka rritur ndjeshëm presionin ndaj mjedisit. Gjatë periudhës së transicionit zhvillimi dhe mjedisi jo gjithnjë kanë qenë në harmoni dhe kanë shkuar në të njëjtin drejtim. Nga ana tjetër, kërkesat për një mjedis të qëndrueshëm janë rritur dhe njëkohësisht edhe ndërgjegjësimi i autoriteteve dhe komunitetit për to, ndërkohë që zbatimi në praktikë ka qenë me i kushtëzuar nga një sërë faktorësh.

Ruajtja e fondit të konsiderueshëm të tokës bujqësore të Komunës Guri i Zi është një tjetër drejtim me rëndësi mjedisor. Studimi Eptiza (2006) thekson se në më të shumtën e vendeve të Evropës Perëndimore komuniteti i fermerëve zakonisht shihet si rojtari kyç i cilësisë së mjedisit rural. Përfitimi mjedisor më i madh do të rrjedhë nga një sektor bujqësor ekonomikisht i arsyeshëm, nëse është i organizuar mirë në mënyrë të mjaftueshme për të dhënë "mbrojtje mjedisore".

Mungesa e kontrollit mbi zhvillimin dhe e planifikimit urban/rural në tërësi në të gjithë vendin kanë çuar në një zhvillim të rastësishëm e të paligjshëm ndërtimesh banimi, duke sjellë degradimin e mjedisit. Për pasojë janë pushtuar zona të mbrojtura dhe ndotur ujërat mbitokësore dhe nëntokësore nga puset e pakontrolluara të hapura nga banorët, të cilat janë të pranishme edhe në Komunën Guri i Zi.

Në kushtet e mungesës së një shërbimi dhe trajtimi në mënyrë bashkëkohore të mbeturinave urbane në Gurin e Zi, largimi apo depozitimi i tyre në vende të papërshtatshme në kundërshtim me normat mjedisore mbart një problem të pazgjidhur dhe akumuluar tashmë ndër vite.

Plani Strategjik i Zhvillimit do të adresojë çështje që ndikojnë në përmirësimin e klimës së mjedisit të shëndetshëm të tillë si:
-Organizimit, grumbullimit, trajnimit dhe përpunimit të mbeturinave urbane dhe menaxhimit të rregullt e të vazhdueshëm të këtij shërbimi
- Edukimi dhe sensibilizimi i komunitetit si dhe organizimi i aksioneve për legjitimimin e mjediseve publike.
- Masat kufizuese e parandaluese të bimëzimit të pakontrolluar të tokës, ajrit dhe ujërave gjatë aktivitetit bujqësor.
- Gjelbërimi i rrugëve dhe mjediseve publike.

Strehimi


Në Komunën Guri i Zi nuk regjistrohen familje të pastreha**.** Megjithatë, nga ana tjetër, ekziston problemi i mprehtë i legalizimeve të masës së ndërtimeve dhe objekteve të banimit të ndërtuara pa leje dhe në mënyrë të pakontrolluar nga individët, të cilët në këtë mënyrë i kanë dhënë zgjidhje me forcat e veta nevojave të tyre të strehimit.

Vitet e fundit, në kuadër të decentralizimit ka disa hapa të rëndësishëm edhe në fushën e administrimit të pronave të pushtetit vendor. Komuna Guri i Zi ka në dispozicion listën e pronave/pasurive publike, sikurse përpunuar nga autoritetet vendore, të miratuar tashme nga Ministria e linjës.



Kapitulli III

Zhvillimi i Ardhshëm i Propozuar në Komunën Guri i Zi



Skema e mësiperme paraqet skemën logjike nëpërmjet të cilës lidhet vizioni i zhvillimit të Komunës, objektivat kryesore të tij si edhe veprimet konkrete të propozuara. Skema përfshin të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e autoriteteve vendore në Komunën Guri i Zi, të veçuara sipas sektorëve të ndryshëm, si edhe përcakton veprimet e duhura dhe të nevojshme për t'u marrë në shqyrtim në secilin sektor përkatës.

3.1 Vizioni i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Guri i Zi si një qendër e rëndësishme rurale në veri të Shqipërisë, me prodhime bujqësore cilësore dhe të bollshme si për tregun vendor por në mënyrë të veçantë për tregun rajonal me qendër në Shkodër;

Guri i Zi, një bashkësi qendrash të vogla policentrike komunitare në juglindje të qytetit të Shkodrës, ku evidentohen tiparet dhe cilësitë pozitive të jetesës në një komunitet të përbashkët dhe ku mbizotëron fryma e bashkëpunimit dhe respektit reciprok midis banorëve;

Guri i Zi, me një mjedis natyror të mirëmbajtur, ku ndërthuren mrekullisht karakteristikat kodrinore të territorit, bukuritë natyrore të liqenit artificial të Vaut të Dejës si dhe fushat pjellore në perëndim;

3.2 Drejtimet e Zhvillimit të Komunës Gur i Zi Sipas Përcaktimeve të Grupit të Qytetarëve

Në dy fazat e para të projektit për përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi, me pjesëmarrjen e grupit të qytetarëve u identifikuan disa drejtime të mundshme strategjike të zhvillimit të zonës[2], të bazuara në tiparet karakteristike të saj, historikun dhe traditën e mëparshme të ecurisë së zhvillimit të Komunës, por edhe në zhvillimet më të fundit strategjike në nivel rajonal, të cilat do të mund t'i hapin fshatrave dhe banorëve të tyre një dimension të ri zhvillimi.

- ***orientimi i zhvillimit ekonomik në Komunë me fokus rigjallërimin dhe forcimin e aktiviteteve prodhuese bujqësore dhe blegtorale;***
- ***riorganizimin e fermave bujqësore në Komunë duke u bazuar në mundësitë reale teknike dhe profesionale si dhe në specifikimin e mëtejshëm të produkteve bujqësore për të cilat ka nevojë tregu;***
- ***eksplorimi i mundësive për nisma të turizmit me fokus agro-turizmin dhe turizmin natyror liqenor;***
- ***zhvillimi i tregtisë bazuar kryesisht tek prodhimet bujqësore dhe blegtorale;***

3.3 Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Komunës

A. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK;
Zhvillim ekonomik i Komunës Guri i Zi duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit prodhues bujqësor, promovimin e aktiviteteve vendore të sipërmarrjes, si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët vendas dhe të huaj

B. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT;
Identifikimin e formave për konsolidimin e qendrave urbane kryesore të fshatrave të Komunës Gur i Zi, si dhe disiplinimin e ndërtimeve të ardhshme rreth këtyre qendrave, duke krijuar dhe forcuar instrumentet e nevojshëm për menaxhimin dhe monitorimin e territoreve urbane dhe rurale.

C. NË FUSHËN E PËRMIRESIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE;
Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Komunës Gur i Zi.

D. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE;
Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Komunën Gur i Zi.

F. NË FUSHËN E RRITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE
Rritja e kapaciteteve financiare të Komunës në funksion të rritjes së mundshme të investimeve për përmirësimin e shërbimeve dhe rolit të saj ndaj komunitetit.

[2] Sipas kritereve të Projektit, grupi i punës së bashkisë identifikoi paraprakisht një listë të pjesëmarrësve të këtij seminari. Qëllimi ishte që të promovohej pjesëmarrja e shumë grupeve përfaqësuese nga Komuna Guri i Zi, nga administrata, këshilli vendor, banorë të fshatrave përreth, përfaqësues të biznesit, rinisë, grave etj.

3.4 Rezultatet e Pritshme dhe Veprimet Konkrete të Propozuara për Zhvillimin e Komunës Guri i Zi.

Duke u bazuar në funksionet dhe përgjegjësitë aktuale të pushtetit vendor në Komunën Guri i Zi, Plani Strategjik i Zhvillimit identifikon:

3.4.1 Objektivi A - Zhvillimi Ekonomik i Komunës

Objektivat kryesore:

- A1. Rivitalizimi i aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet rritjes së investimeve nga ana e investitorëve vendas dhe të huaj
- A2. Stimulimi dhe mbështetja e aktiviteteve të vogla ekonomike prodhuese përgjatë rrugës kryesore rajonale që lidh Vaun e Dejës me qytetin e Shkodrës dhe që kalon përmes territorit të Komunës Guri i Zi
- A3. Promovimi dhe mbështetja e agroturizmit dhe turizmit natyror me fokus liqenin artificial të Vaut të Dejës.

A1. Rivitalizimi i aktiviteteve ekonomike bujqësore dhe blegtorale dhe rritja e investimeve vendase dhe të huaja

Zhvillimi dhe konsolidimi i aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale në Komunën Guri i Zi varet direkt në sipërmarrjen private të banorëve të Komunës. Në këtë kuadër, administrata vendore duhet të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e këtyre sipërmarrjeve private. Për këtë qëllim është e nevojshme marrja e një sërë masave specifike duke u bazuar në prioritetet e zhvillimit si dhe në potencialet që ofron zona.

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Përmirësimi i sistemit të të dhënave për tokën bujqësore në Komunën Guri i Zi	1. Vlerësimi teknik i të dhënave dhe bazës hartografike të tokës bujqësore në Komunë 2. Krijimi i strukturës administrative të nevojshme për përmirësimin e bazës së të dhënave për token bujqësore (krijimi i një grupi përgjegjës) 3. Identifikimin e projekteve konkrete për gjenerimin e fondeve të nevojshme për krijimin dhe përmirësimin e bazës së të dhënave
b. Përmirësimi i nivelit të informimit të fermerëve në Komunë për sa i përket çmimeve apo kërkesës për produkte bujqësore dhe blegtorale në nivel rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar.	1. Lobim me fermerët vendas (bujqit dhe blegtorët) apo me shoqatat vendore për sa i përket krijimit të qendrës së informimit si dhe mënyrës së funksionimit të saj, (hapja e një procesi takimesh dhe diskutimesh) 2. Krijimi i qendrës së informacionit në nivel Komune (zyrë e posaçme informimi), 3. Investime në sistemet elektronike të informacionit lidhur me çmimet e produkteve bujqësore dhe blegtorale (lidhja me linjën e internetit)
c. Promovimi i krijimit të fermave të mëdha bujqësore dhe blegtorale.	1. Organizimi i një anketimi të plotë në të gjithë territorin e Komunës, për të identifikuar çështjet dhe problemet lidhur me ngritjen e fermave bujqësore dhe blegtorale; cilat janë mënyrat më të mundshme për këtë, 2. Përgatitja e një studimi / plan biznesi i mundësisë së krijimit të fermave bujqësore dhe blegtorale 3. Organizimi i një forumi periodik, të hapur me bujqit dhe blegtorët në Komunë, për të marre opinionet e tyre për mundësinë / problemet e krijimit të fermave

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
d. Promovimi i Komunës Guri i Zi si një Komunë me potenciale të mëdha për prodhimin e kulturave bujqësore dhe blegtorale	1. Përgatitja e një studimi për vlerësimin e kapaciteteve prodhuese të Komunës për produkte bujqësore dhe blegtorale. 2. Përgatitja e materialeve promovuese të Komunës Guri i Zi lidhur me kapacitetet prodhuese të saj si dhe publikimi i tyre.
e. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore	1. Hartimi i një vlerësimi teknik të gjendjes ekzistuese të rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në territorin e Komunës si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve të nevojshme përmirësuese. 2. Përgatitja e projekteve konkrete teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të tokave bujqësore në Komunë 3. Organizimi i takimeve periodike me Bordin e Kullimit lidhur me mundësinë e ndërhyrjes në rrjetin e kanaleve kulluese në zonë.

A2. Stimulimi dhe mbështetja e aktiviteteve të vogla ekonomike prodhuese përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Kryerja e një vlerësimi të plote teknik lidhur me situatën dhe nevojat për investime në këtë korridor	1. Ngritja e një ekipi teknik për kryerjen e vlerësimit. 2. Përgatitja dhe kryerja e një pyetësori për bizneset ekzistuese në zonë, lidhur me mundësitë dhe nevojat për përmirësim të aktivitetit të tyre. 3. Finalizimi i studimit teknik duke përcaktuar ndërhyrjet e nevojshme në infrastruktura dhe shërbime për aktivitete ekonomike në korridorin kryesor të Komunës.
b. Përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve në shërbim të aktiviteteve ekonomike të korridorit kryesor rrugor në Komunë	1. Përcaktimi i një programi ndërhyrjesh në funksion të gjetjeve të studimit teknik për korridorin kryesor. 2. Kryerja e ndërhyrjeve të vogla përmirësuese në infrastrukturat e korridorit kryesor ekonomik të Komunës. 3. Përgatitja e projekt propozimeve të ndryshme teknike për përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve në korridorin e ekonomik të Komunës.

A3. Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit natyror liqenor në territorin e Komunës Guri i Zi

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete
a. Përgatitja e profilit vendor të Komunës lidhur me këto funksione dhe shërbime të reja	1. Përgatitja e një studimi teknik ku të përcaktohen format konkrete të zhvillimit të aktiviteteve turistike në zonën e Gurit të Zi si dhe cilat do të jenë nevojat për ndërhyrje dhe investime. 2. Diskutimi i këtij profili me përfaqësuesit kryesore në Komunë si dhe në Rajonin e Shkodrës ku të gjenerohen ide të reja dhe mundësi konkrete investimi.
b. Identifikimi i ndërhyrjeve në rrjetet e infrastrukturës	1. Përgatitja e projekteve teknike për infrastrukturat turistike në Komunës 2. Përgatitja e projekt propozimeve për financim nga donatorë të ndryshëm.

3.4.2 Objektivi B - Menaxhimi i Territorit në Komunën Guri i Zi

Duke iu referuar tendencave të zhvillimit territorial të Komunës Guri i Zi, rritjes së shpejtë të zonave urbane përgjatë korridorit kryesor të Komunës si dhe zënies së tokës bujqësore nga ndërtimet rezidenciale, është e nevojshme marrja e masave konkrete dhe të shpejta.

Objektivat Kryesore:

- B1. Mbrojtja e fondit të tokës bujqësore në Komunë dhe orientimi i zhvillimeve të ardhshme urbane drejt qendrave të propozuara përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës
-
- B2. Kontrolli dhe menaxhimi i zhvillimeve urbane rezidenciale në Komunën Guri i Zi

- B3. Mbrojtja e mjedisit në Komunën Guri i Zi

Objektivi B1 - Thuajse i gjithë fondi i tokës bujqësore ekzistues në Komunën Guri i Zi është në pronësi private, kështu që marrja e masave të nevojshme për përmirësimin e gjendjes së tokës në të ardhmen, ka lidhje të drejtpërdrejtë me nivelin e bashkëpunimit midis Komunës dhe banorëve të saj. Për këtë qëllim, lidhur me menaxhimin e zhvillimeve të ardhshme të tokës, Komuna duhet të angazhohet në:

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Përmirësimi i sistemit të kontrollit ndaj ndërtimeve të reja në Komunë	1. Krijimi dhe konsolidimi i strukturës së Inspektoratit të Ndërtimit në Komunë 2. Identifikimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Inspektoratit të Ndërtimit në Komunë duke qartësuar edhe kërkesat për financime të mëtejshme. 3. Nisja e bashkëpunimit me Komunat fqinje si dhe me Qarkun Shkodër për sa i përket mbështetjes dhe koordinimit të kontrollit mbi tokën bujqësore
b. Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa.	1. Përgatitja dhe miratimi në Këshillin Vendor të Komunës Guri i Zi i një pakete masash penalizuese për ndërtimet në tokat bujqësore nën administrimin e Komunës. 2. Përgatitja e materialeve informuese për banorët e Komunës Guri i Zi lidhur me masat që do të merren në rastet e ndërtimeve pa leje të objekteve.
c. Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe orientimin e ndërtimeve në këto territore	1. Përgatitja dhe diskutimi i një pakete taksash të posaçme për ndërtimet ekzistuese në territoret urbane dhe ato bujqësore të Komunës në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore si dhe me Ligjin për Taksat Vendore 2. Organizimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të Komunës Guri i Zi për të rritur nivelin e grumbullimit të taksës së pronësisë mbi tokën si dhe menaxhimin e tyre
d. Orientimi i zhvillimeve urbane dhe ekonomike përgjatë aksit kryesor rrugor të Komunës dhe qendrave të propozuara në materialet hartografike	1. Identifikimi në terren i kufijve të zonave të propozuara urbane të fshatrave të Komunës 2. Përgatitja e një vlerësimi teknik lidhur me nevojat për infrastrukturë në zonat e përcaktuara të konsolidimit urban të Komunës 3. Përgatitja e projekteve të ndryshme për financim lidhur me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturave në zonat e propozuara të konsolidimit urban në Komunën Guri i Zi
e. Mbrojtja e zonave të dëmtuara apo të rrezikuara në territorin e Komunës Guri i Zi	1. Vlerësimi në terren dhe përgatitja e një materiali të plotë hartografike ku të përcaktohen zonat e dëmtuara dhe të rrezikuara në territorin e Komunës si dhe nevojat për ndërhyrje. 2. Përgatitja e projekt propozimeve lidhur me përmirësimin e gjendjes së zonave të dëmtuara dhe të rrezikuara. 3. Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës lidhur me nevojën për mbrojtjen e zonave të rrezikuara dhe të dëmtuara si dhe diskutimin e mundësive të ndërhyrjeve si dhe financimeve të nevojshme. 4. Kryerja e investimeve të vogla përmirësuese për zonat e dëmtuara në Komunë.

B2. Kontrolli dhe menaxhimi i zhvillimeve urbane rezidenciale në Komunë

Pjesa më e madhe e zonave të banimit të Komunës Guri i Zi kanë një dendësi tepër të ulët, ku mbizotërojnë banesat rezidenciale me oborr të brendshëm të madh. Sipërfaqet e oborreve janë të konsiderueshme, ndërkohë që në Komunë nuk ka një treg të mirëfilltë të tokës urbane. Ky fakt si dhe mungesa e planeve konkrete urbane për fshatrat, ka bërë që banorët të kenë tendencën për të ndërtuar në tokat e tyre bujqësore që i kanë në pronësi. Kjo ka shkaktuar një shpërndarje të pakontrolluar të ndërtesave të reja rezidenciale në tokat bujqësore, gjë që është shumë e dalluar sidomos në fshatrat Juban, Guri i Zi, Vukatanë dhe Rrancë. Kjo lloj tendence e bën furnizimin nga ana e Komunës të zonave të reja me shërbime dhe infrastrukturë thuajse të pamundur.

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Promovimi dhe informimi i banorëve të Komunës lidhur me përcaktimet për mënyrën e zhvillimit të zonave urbane	1. Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës ku të diskutohen propozimet lidhur me kufijtë dhe mënyrën e zhvillimit urban në të ardhmen. 2. Përgatitja dhe vendosja e tabelave informuese në fshatrat e Komunës ku të qartësohen kufijtë e propozuar si dhe profilet e rrugëve kryesore.
b. Rritja e Kapaciteteve të komunës lidhur me menaxhimin dhe kontrollin e territoreve urbane të saj	1. Organizimi dhe mbështetja e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve për kontrollin dhe administrimin e territorit në Komunë. 2. Investimi për përmirësimin e bazës teknike për administrimin dhe monitorimin e territorit në Komunë, duke u fokusuar në arkivimin e të dhënave teknike dhe hartografike 3. Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e mundshëm të konsolidimit të bazës së të dhënave urbanistike të Komunës Guri i Zi lidhur me projektet e ndërtesave ekzistuese apo dhe infrastrukturave përkatëse.
c. Të stimulojë dhe të vazhdojë procesin për përgatitjen e studimeve pjesore urbane për të gjitha territoret urbane në Komunë.	1. Përgatitja e një programi pune (faza) për hartimin e studimeve urbane për zonat e propozuara në Plan 2. Përgatitja e bazës së të dhënave të nevojshme për hartimin e planeve urbane të fshatrave të Komunës 3. Përgatitja e Detyrave të Projektimit për planet urbane të fshatrave 4. Përgatitja e projekt propozimeve për donatorë të lidhur me mundësinë e financimit për përgatitjen e planeve urbane të fshatrave të Komunës

B3. Mbrojtjen e mjedisit në Komunën Guri i Zi

Duke qenë një Komunë me strukturë demografike konstante dhe e bazuar tërësisht në prodhimet bujqësore dhe blegtorale, administrata vendore duhet të koordinojë në mënyrë të kujdesshme zhvillimin e këtyre aktiviteteve me mbrojtjen e karakteristikave të mjedisit si dhe përmirësimin e kushteve natyrore në të gjithë territorin e Komunës.

Rezultatet e pritshme	Veprimet Konkrete të Propozuara
a. Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve të Komunës lidhur me çështjet e mbrojtjes së mjedisit	1. Organizimi i aktiviteteve periodike në nivel Komune ku të trajtohen dhe të referohen problemet aktuale që ka Komuna lidhur me dëmtimet në mjedis. 2. Përgatitja dhe vendosja e tabelave informuese në qendër dhe në fshatrat e Komunës ku të specifikohen zonat problematike mjedisore në Komunë
b. Marrja e masave konkrete për përmirësimin e zonave të dëmtuara në territorin e Komunës	1. Përgatitja e një programi ndërhyrjeje në mjedisin për Komunën Guri i Zi 2. Organizimi i aktiviteteve periodike, në bashkëpunim me shkollat e Komunës për pastrimin dhe sistemimin e zonave të ndotura nga hedhjet e pakujdesshme 3. Përgatitja e projekteve teknike për financim për zonat e dëmtuara apo të rrezikuara në të gjithë territorin e Komunës

INSTRUMENTAT E MENAXHMIT TË TERRITORIT

Në lidhje me përcaktimin dhe orientimin e shpërndarjes hapësinore të zonave të banimit, zonave mikse si dhe atyre ekonomike në Komunën e Gurit te Zi, në vijim paraqiten në këtë dokument, hartat me shpjegimet përkatëse.

Qëllimi i tyre është që të shprehin nëpermjet organizimit të hapësirës territoriale objektivat kryesore ekonomike, sociale dhe ambjentale të Komunës. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktoreve privatë apo publike mundësinë për të bashkëvepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar.
Nga ana tjetër, ato do të aftësoje mobilizimin e komunitetit më tej, drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta.

Qëllimi kryesor i këtyre materialeve të paraqitura është të orientoje zhvillimin, parë në këndvështrimin e menaxhimit të territorit. Në rastin e Komunës së Gurit të Zi, këto instrumenta synojnë:

- Të drejtojnë përdorimin e përgjithshëm të tokës duke përcaktuar kornizat për zhvillimin territorial të Komunës Guri i Zi.
- Të përcaktojnë korridoret kryesore të transportit.
- Të përcaktojnë zonat mikse si dhe ato ekonomike.

A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

1. Në llojin e parë janë të përfshira **Zonat e Konsolidimit Urban**, të cilat kanë nevojë dhe janë subjekt për hartimin e Planeve të Përgjithshme Rregulluese në të ardhmen, të Master Planeve tematike apo Studimeve të tjera specifike (si psh Studime të Detajuara Pjesore etj...). Në të njejtën kohë këto zona kanë nevojë të plotësohen me gjithë infrastrukturën fizike dhe sociale të nevojshme për një zonë banimi dhe shërbimet përkatëse (rrjeti rrugor, sistemi i kanalizimeve, furnizimi dhe ujë dhe energji elektrike, transporti publik, shkolla, kopshte, qëndra shëndetësore e sociale etj…). Dendësia e propozuar bruto në ketë zonë është 100 banore/Ha, ndërsa dendësia neto është 140 banore/Ha. Në këtë zonë propozohet të lejohen dhe inkurajohen (duke u bazuar në politikat vendore perkatëse) ndërtime të reja me qëllim konsolidimin e zonës dhe rritjen e eficences se shërbimeve publike. Në këtë zonë bëjnë pjesë fshatrat si: Juban, Guri i Zi, Vukatana, Gajtani, Rrënci dhe Kuçi.

2. Në llojin e dytë janë të përfshira **Zonat e Ngrirjes Urbane,** të cilat nuk paraqesin nevojë për Plane të Përgjithshme Rregulluese pasi propozimi konsiston, në reduktimin dhe ndalimin e ndërtimeve të reja në të ardhmen.Në zonat e llojit të dytë janë kryesisht zona lindore e Komunës por edhe fshatrat si, Rragami e Ganjolla.

Objektivat që kanë orientuar propozimet e mësipërme janë:

- Të ndihmojnë në konsolidimin e zonës urbane.
- Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efiçencës se shërbimeve në zonën urbane
- Të ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturave në zonën urbane e më tej.

PLANI STRATEGJIK KOMUNA G



Instrumentat e Menaxhimit te Tokes

KUFIRI ADMINISTRATIV
I KOMUNES GURI I ZI

SHKODER

RRENC

KUCI

VUKATANA

lumi i Drinit

lumi i Drinit

KOMUNA GURI I ZI


inter cooperation

Co-PLAN

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Condeferazione Svizzera
Confederaziun svizra


Swiss Cooperation Office Albania

GURI I ZI


Liqeni i Vau te Dejes
RRAGAMI
GAJTANI
GURI I ZI
JUBANI
GANJOLLA
VAU I DEJES
Legjenda
Zonat qe do te Plotesohen me Studime Urbane & Projektet e Infrastrukturave
(Studime Urbane: Plane Rregulluese, Studime Pjesore, Dizain Urban etj.)
Zonat qe do te jene ne Ngrirje
Zonat qe do te Plotesohen me Projekte te Detajuara te Dizainit Urban

PLANI STRATEGJIK KOMUNA GURI I ZI

Propozime per Nderhyrje ne Rrjetin Rrugor




KOMUNA GURI I ZI

Inter cooperation


Co-PLAN

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


Swiss Cooperation Office Albania



RRUGET NE BRENDESI TE FSHATRAVE



RRUGET LIDHESE MES FSHATRAVE



LEGJENDA

ZONA BANIMI

RRUGET NE BRENDESI TE FSHATRAVE

RRUGET LIDHESE MES FSHATRAVE

B. Zona specifike:

Zona specifike të paraqitura në hartë:

- **Zonat ekonomike:** këtu do të nënkuptojme zonat e destinuara per zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimeve përkatëse. Këto zona janë të vendosura pergjatë rruges kryesore të Komunës Guri i Zi, si dhe një zonë tjetër në afërsi të fshatit të Vukatanës.

Komuna e Guri të Zi, nëpermjet Instrumentave të Menaxhimit të Territorit ka evidentuar hapin e pare drejt studimeve të detajuara, që do t'i nevojiten në të ardhmen për të organizuar territorin e saj si njësi vendore, bazuar në maksimalizimin e burimeve dhe minimizimin e kostove.

Këto instrumenta të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në bazë të prioriteteve dhe të planeve te veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik të Zhvillimit.

3.4.3 Objektivi C - Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve Publike në Komunën Guri i Zi

Në bazë të Ligjit Organik për Pushtetin Vendor në Shqipëri, Komuna Guri i Zi ka përgjegjësinë për furnizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave sociale dhe fizike si dhe ofrimin e shërbimeve për banorët e saj. Duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të evidentuar në profilin e Komunës në Kapitullin II si dhe në drejtimet e propozuara të zhvillimit të kësaj Komunë, Plani Strategjik i Zhvillimit propozon:

C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Komunën Guri i Zi duke u bazuar në përmirësimin e komunikimit të banorëve të fshatrave të ndryshëm si dhe mbështetjen ndaj aktiviteteve ekonomike vendore

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Identifikimi i nevojave për ndërhyrje konkrete në infrastrukturën rrugore të Komunës Guri i Zi	1. Përgatitja e një studimi teknik lidhur me gjendjen ekzistuese të rrugëve të Komunës Gur i Zi ku të evidentohen qartë akset e dëmtuara, akset që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente si dhe akset për rrugët e mëvonshme. 2. Organizimi i takimeve me komunitetet vendore të fshatrave të Komunës për të diskutuar dhe përcaktuar nevojat për ndërhyrje në rrjetet rrugore
b. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes teknike në rrjetin rrugor	1. Përgatitja e Detyrave të Projektimit për projektet e rikonstruksionit të rrugëve në fshatrat e Komunës 2. Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e projekteve teknike të rrugëve të Komunës
c. Kryerjen e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të Komunës	1. Planifikimi dhe prokurimi i investimeve të vogla periodike vjetore për përmirësimin e rrjetit rrugor të Komunës 2. Identifikimi i një plani investimesh në rrjetin rrugor në kuadër të zbatimit të propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit (materialet Hartografike)

C2. Përmirësimi i gjendjes së ujësjellësit në territorin e Komunës

Duke qenë së pjesa më e madhe e fshatrave të Komunës nuk disponojnë furnizim të plotë me ujë të pijshëm, si dhe për nivelin e madh të investimeve që kërkon ky shërbim në këtë Komunë, është e rëndësishme që zgjidhja e problemit të shihet në një mënyrë strategjike dhe afatgjate. Sipas të dhënave të Komunës si dhe nga verifikimet në terren, Komuna Guri i Zi disponon mjaftueshëm burime ujore për furnizimin me ujë të popullatës. Aktualisht, furnizimi me ujë nuk është kaluar në pronësi dhe përgjegjësi të Komunës. Duke marrë parasysh mungesat që ka në këtë shërbim, si dhe kalimin e ujësjellësit në pronësi të administratës së Komunës, duhet të kalohet në hapat e mëposhtëm:

Rezultatet e pritshme	Ndërhyrje konkrete të propozuara
a. Analiza dhe identifikimi i nevojave për furnizimin me ujë të fshatrave të Komunës Guri i Zi	1. Hartimi i një studimi fizibiliteti lidhur me nevojat për furnizim me ujë për banorët, gjendjen ekzistuese të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave të Komunës si dhe nevojat për investime në të ardhmen. 2. Krijimi i një baze të dhënash të përditësuara hartografike të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave 3. Kryerja e inventarizimit të aseteve të ujësjellësve të fshatrave dhe miratimi i tyre në Këshillin Vendor të Komunës.
b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve në territorin e Komunës	1. Përgatitja e projekteve teknike për rrjetet e ujësjellësve të fshatrave të Komunës ku mungon ky shërbim. 2. Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave të Komunës Guri i Zi.
c. Rritja e kapaciteteve menaxhuese lidhur me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujërave	1. Përgatitja e një vlerësimi nevojash për rritje kapacitetesh për menaxhimin e rrjeteve të ujësjellësve në Komunë. 2. Organizimi dhe mbështetja e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve për stafin përkatës për menaxhimin dhe kontrollin e rrjeteve të ujësjellësve në Komunë.

C3. Përmirësimi i sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza

Duke qenë se rrjetet e kanalizimeve të ujërave të zeza janë tepër problematike për sa i përket shëndetit, është e nevojshme që të rishikohet dhe të vlerësohet një ndërhyrje tërësore në të gjithë sistemet e fshatrave. Aktualisht, ujërat e zeza përfundojnë në kanale apo në gropa septike jo teknologjike të cilat rrezikojnë ndotjen e ujërave nëntokësore me të cilat furnizohen edhe puset e shumta të fshatrave. Për këtë qëllim duhet të ndërmerren masa urgjente për t'i paraprirë problemeve që mund të shfaqen në shëndetin e popullatës në Komunë.

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Rritja e mundësive financiare për të investuar në rrjetin e kanalizimeve	1. Përgatitja e projekt propozimeve drejtuar donatoreve të ndryshëm për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve të fshatrave të Komunës 2. Organizimi i takimeve periodike me Qarkun Shkodër, donatorë apo me investitorë të mundshëm për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve
b. Krijimi i kuadrit të plote teknik për rrjetin e kanalizimeve në Komunë	1. Përgatitja e projekteve të plota teknike për rrjetet e kanalizimeve në Komunën Guri i Zi 2. Diskutimi dhe përcaktimi i një pike për depozitimin dhe dekantimin e ujërave të zeza për fshatrat e zonës fushore në Komunë

C4. Grumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave urbane

Praktikisht, si në shumicën e fshatrave në Shqipëri, organizimi i proceseve të grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane kërkon paraprakisht vlerësimin e saktë të mundësive teknike dhe financiare që ka Komuna për të ofruar këtë shërbim. Komuna nuk ka për momentin kapacitete financiare për të nisur dhe zhvilluar një sistem të mirëfillte dhe efeçient grumbullimi dhe trajtimi të mbeturinave urbane. Në funksion të një lidhje afatgjatë me sistemin rajonal të depozitimit të mbeturinave në Bushat, Komuna Guri i Zi duhet të identifikojë një skemë të përkohshme për këtë shërbim.

Rezultate të pritshme	Veprime konkrete të propozuara
a. Përgatitja e një plani grumbullimi dhe menaxhimi të mbeturinave urbane në territorin e Komunës Guri i Zi	1. Organizimi i punës si dhe ngritja e një grupi të posaçëm për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave të Komunës. 2. Organizimi i një ankete në nivel Komune për çështjet që kanë të bëjnë me grumbullimin e mbetjeve urbane.
b. Identifikimi i një pike të përkohshme për depozitimin e mbeturinave për të gjithë territorin	1. Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e fshatrave të Komunës për të identifikuar dhe miratuar një pikë për depozitimin e përkohshëm të mbeturinave. 2. Përgatitja e vlerësimit të ndikimit në mjedis të pikës së përkohshme të grumbullimit të mbeturinave në Komunë.

C5. Përmirësimi i gjendjes fizike të shkollave dhe kopshteve në territorin e Komunës Guri i Zi

Rezultatet e pritshme	Ndërhyrje konkrete të propozuara
a. Identifikimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat dhe në kopshtet e Komunës	1. Përgatitja e një studimi teknik në terren për të identifikuar nevojën për përmirësime fizike dhe logjistike në të gjitha shkollat dhe kopshtet e Komunës
b. Përgatitja e projekteve teknike për financim të mundshëm nga ana e shtetit apo e donatorëve	1. Përgatitja e disa projekt- propozimesh drejtuar qeverisë qendrore apo donatorëve të ndryshëm lidhur me mundësinë e financimit të ndërhyrjeve përmirësuese në shkolla dhe në kopshte. 2. Përgatitja e projekteve teknike të ndërhyrjeve përmirësuese ku të evidentohen qartë llojet dhe volumet e ndërhyrjeve si dhe kostot përkatëse.
c. Promovimi i forumeve vendore lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e Komunës	1. Organizimi i takimeve periodike në nivel Komune midis grupeve mësimore si dhe përfaqësuesve të prindërve lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies si dhe kushteve në shkollat e Komunës Guri i Zi

3.4.4 Objektivi D – Qeverisja e Mirë

Për sa i përket arritjes së këtij objektivi të rëndësishëm, Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi përcakton:

- Rritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative të stafit të Komunës Gur i Zi.
- Përmirësimi i nivelit të transparencës në vendimmarrjen vendore në Komunë.
- Përmirësimi i pjesëmarrjes së komunitetit vendor në vendimmarrjen në Komunë.

D.1 - Rritja e kapaciteteve të stafit në Komunën Guri i Zi

Rezultate të pritshme	Veprime konkrete të propozuara
a. Vlerësimi i skemës organizative të Komunës dhe identifikimi i nevojave për përmirësim.	1. Analiza institucionale e skemës organizative të Komunës Guri i Zi, duke u fokusuar në përmirësimin e efiçiencës së shërbimeve si dhe të funksionimit normal të infrastrukturave publike. 2. Konsolidimi i Zyrës së Koordinim Zhvillimit në Komunën Guri i Zi.
b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të administratës së Komunës.	1. Organizimi i trajnimeve periodike për rritjen e kapaciteteve të stafit të Komunës Guri i Zi në fushat e menaxhimit të territorit si dhe të shërbimeve publike. 2. Organizimi i trajnimeve për menaxhimin financiar në administratën e Komunës. 3. Vlerësimi i përcaktimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit për Komunën si dhe i përgjegjësive që ajo identifikon për administratën.

D2. Rritja e nivelit të transparencës në Vendimmarrjen Vendore në Komunën Guri i Zi

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Afishimi dhe shpërndarja e informacionit lidhur me aktivitetet dhe projektet e ndërmarra në Komunë.	1. Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës informative në Komunën Guri i Zi. 2. Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Gur i Zi.
b. Rritja dhe promovimi i pjesëmarrjes së publikut në mbledhjet e Këshillit Vendor në Komunë.	1. Përgatitja dhe afishim periodik i njoftimeve për rezultatet dhe vendimet e marra gjatë mbledhjeve të Këshillit Vendor të Komunës Guri i Zi.

D3. - Buxhetimi me Pjesëmarrje

Zbatimi i një procesi të suksesshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, për shkak të kapaciteteve të pakta financiare të Komunës Guri i Zi, ka nevojë të financohet nëpërmjet burimeve alternative të mundshme financiare. Me gjithë vështirësitë që paraqiten është e rëndësishme që administrata e Komunës të insistojë për fillimin dhe konsolidimin e zbatimit të suksesshëm të buxhetimit me pjesëmarrje. Për këtë, është e nevojshme:

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Ngritja e kapaciteteve të administratës së komunës për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje.	1. Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit përgjegjës të Komunës Guri i Zi, për organizimin dhe monitorimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje.
b. Organizimi i aktiviteteve periodike të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Komunë.	1. Financimi i organizimit vjetor të Buxhetimit me pjesëmarrje në Komunën Guri i Zi.

3.4.5 Objektivi F - Zhvillimi i Burimeve Financiare në Komunën Guri i Zi

Ky është një nga komponentët më të rëndësishëm të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi pasi vetëm nëpërmjet tij bëhet e mundur arritja e objektivave të zhvillimit dhe zbatimi i veprimeve konkrete në Planin e Veprimit.

F1. Rritja e të ardhurave vendore të Komunës Guri i Zi

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Vlerësimi i saktë i mundësive reale për gjenerim të ardhurash nga taksat vendore në territorin e Komunës.	1. Përgatitja e një studimi konkret për të identifikuar të ardhurat potenciale që mund të gjenerojë Komuna Guri i Zi nga taksat e pronës (toka bujqësore si dhe banesat). 2. Ngritja e një sistemi informacioni të posaçëm për vlerësimin dhe monitorimin e grumbullimit të taksave vendore të Komunës Guri i Zi.
b. Rritja e eficiences së shërbimeve dhe shpenzimeve në nivel Komune.	1. Përgatita e një analize të plotë institucionale në nivel Komune ku të trajtohen çështje të funksioneve të Komunës, shpenzimeve që ajo kryen si dhe nevojat për përmirësimin e efiçences së punës së administratës.

F2. Promovimi dhe rritja e investimeve vendore dhe të huaja në Komunë.

Rezultatet e pritshme	Veprimet konkrete të propozuara
a. Krijimi i një klime me të mirë për biznesin në Komunë	1. Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit të biznesit në Komunën Guri i Zi ku të trajtohen problemet që ata kanë si dhe mundësitë për bashkëpunim me autoritetet.
b. Promovimi i burimeve, karakteristikave dhe avantazheve që ofron Komuna për investitorët.	1. Përgatitja e materialeve promovuese, postera, fletëpalosje, etj, ku të paraqiten anët pozitive të Komunës, zonat me interes investimi, zonat me vlera natyrore, historike, turistike etj. 2. Organizimi i panaireve në zonën e Komunës Guri i Zi ku të ekspozohen vlerat dhe produktet që ka kjo zonë.
c. Hartimi i projekt propozimeve për të mundësuar financime të ndryshme në territorin e Komunës.	1. Përgatitja e projekteve të ndryshme drejtuar donatorëve të ndryshëm për financim

Disa nga mundësitë që Komuna Guri i Zi të gjenerojë të ardhura shtesë të nevojshme për investime, janë:

- **Grantet konkurruese nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

Këto grante janë të kufizuara deri në kuotën e 25,000 EURO në vit (shifra të qartësohet) si dhe janë të orientuara në përmirësimin e infrastrukturave rrugore të njësive vendore (rrugët dytësore).

- **Hua të ndryshme nga bankat e nivelit të dytë**

Në bazë të Ligjit të ri të miratuar për Huamarrjen Vendore, Komuna Guri i Zi ka mundësinë ligjore të marrë hua afatgjata nga institucione të ndryshme financiare në varësi të kapitaleve (kolateralit) që ajo mund të gjenerojë, si dhe në varësi të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Ajo që duhet pasur parasysh në këtë rast është që kësti vjetor (shërbimi i borxhit) që duhet paguar nuk duhet të tejkaloje 20% të vlerës së buxhetit vjetor të Komunës Guri i Zi, (granti i pakushtëzuar + taksat dhe tarifat vendore).

Një mundësi e mirë për Komunën Guri i Zi janë financimet që mund të sigurohen në kuadër të IPA (*Instruments for Pre-Accesssion Assistance*), që është një program për të asistuar vendet që aspirojnë të bashkohen në

Bashkimin Evropian. Programi IPA ka një shtrirje kohore prej 2007 – 2013 dhe qëllimi kryesor i tij është që të rrisë efiçiencën dhe koherencën e fondeve të dhëna për asistencë, në kuadër të një kuadri bazë, të njëjtë për të gjitha vendet aspirante.

Shqipëria është një nga vendet potenciale për kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Programi IPA përbëhet nga 5 komponentë bazë që janë:

1. mbështetje për proçesin e transicionit dhe të rritjes institucionale
2. bashkëpunimin ndërkufitar
3. zhvillimin rajonal
4. zhvillimin e burimeve njerëzore
5. zhvillimin rural

Siç vihet re, të gjithë komponentët e programit janë tepër të rëndësishme për kontekstin e zhvillimit të Komunën Guri i Zi. Për këtë arsye, administrata vendore duhet që t'i paraprije proceseve duke rritur kapacitetet e saj dhe nivelin e informacionit për sa i përket këtij programi dhe mundësive që ai paraqet. Pozicioni gjeografik i Gurit të Zi, profili rural bujqësor si dhe kuadri rajonal në të cilin ndodhet, krijojnë premisa të mira për financime të mundshme, të cilat duhen shqyrtuar me vëmendje.

Për më tepër, është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i mundësive të bashkëpunimit në sfera të ndryshme me njësite vendore të Komunës Guri i Zi, duke u fokusuar në mundësinë e tërheqjes së financimeve nga fonde dhe programe të reja të Bashkimit Evropian për zhvillimin vendor dhe rajonal. Është e nevojshme gjithashtu që të vlerësohet mundësia e krijimit të "shoqatave funksionale", për qëllime të ndryshme si p.sh: menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimeve etj.

Mundësi të tjera për financim për Komunën Guri i Zi përfshijnë grante dhe programe të pritshme nga Bashkimi Evropian, fonde të ADF, Fonde të Granteve Konkurruese etj. Administrata e Komunës ka për detyrë që të rrisë kapacitetet e saj nëpërmjet trajnimeve apo ekspertizës teknike për të adresuar sa më shumë financime në territorin e vet.



Kapitulli IV

Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të propozuar për Komunën Guri i Zi

4.1 Ndërhyrjet Institucionale të Propozuara

Komuna Guri i Zi, nëpërmjet Kryetarit dhe administratës vendore, janë përgjegjësit kryesorë për zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit. Për të rritur eficiencën e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshtë:

- Të ngrihet grupi i zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës Guri i Zi, brenda strukturës administrative ekzistuese, i cili do të jetë përgjegjës kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Komunës, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet, grupi duhet të jetë nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik të Zhvillimit me proçeset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.

- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Departamentit të Koordinim Zhvillimit në Komunën Guri i Zi, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe Projekt Propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.

- Riorganizimi administrativ i Komunës Guri i Zi duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuara në Planin e Veprimit të propozuara si p.sh: krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendorë për çështje të buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit, etj; organizimi dhe moderimi i "shoqërive funksionale" në bashkëpunim me njësite vendore fqinje etj

- Fokusimi në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performanës.

- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Komunë për t'i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.

- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Komunës Guri i Zi sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.

- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre të administratës lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

4.2 Plani i Detajuar i Veprimit

4.2.1 Plani i veprimit - Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2008

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit	B2c1	Përgatitja e një programi pune (faza) për hartimin e studimeve urbane për zonat e propozuara në Planin Strategjik të Zhvillimit të komunës	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim -Zhvillimit, etj	0 Lekë	Plani i punës specifikohet në bazë të njësive që duhen studiuar si dhe të përgjegjësive që duhet të ndjekë zyra e koordinim - zhvillimit.
D-Qeverisja e Mirë	D1b2	Organizimi i trajnimeve për menaxhimin financiar në administratën e Komunës	Komuna, Intercooperation Albania, URI	Financimi vjen nga Inetercooperation	Modulet e trajnimit do të përgatiten dhe finalizohen nga Intercooperation Albania
	D1b3	Vlerësimi i përcaktimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit dhe përgjegjësive që ai identifikon për administratën e Komunës	Komuna, Intercooperation Albania, ekspertë të posaçëm, etj	0 Lekë	Kjo konsiston në formatimin dhe zbatimin e një procesi të tërë, ku ekspertë të posaçëm si dhe përfaqësues të Komunës kryejnë vlerësimin dhe monitorimin e planit të aktiviteteve të propozuar
	D1a2	Konsolidimi i Zyrës së koordinim zhvillimit në Komunën Guri i Zi	Kryetari i Komunës, ekspertë të posaçëm etj	200,000 Lekë	Aktiviteti konsiston në përcaktimin e programit të punës së këtij zyre, në koordinimin e këtij programi me Planin e aktiviteteve të PSZH si dhe në përgjegjësitë e secilit.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C4a1	Organizimi i punës si dhe ngritja e një grupi të posaçëm për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave të Komunës	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim -Zhvillimit, ekspertë mjedisorë etj	0 Lekë	Grupi i punës do të jetë përgjegjës për përgatitjen e plan veprimit si dhe zbatimin e tij.

4.2.2 Plani i Veprimit - Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2009

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1a3	Identifikimi i projekteve konkrete për gjenerimin e fondeve të nevojshme për krijimin dhe përmirësimin e bazës së të dhënave të tokës bujqësore	Zyra e koordinim Zhvillimit	100,000 Lekë	Këto projekte mund t'i adresohen Ministrisë së Bujqësisë, apo donatorëve të ndryshëm që operojnë në zonën e Shkodrës.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1c1	Organizimi i një anketimi të plotë në të gjithë territorin e Komunës, për të identifikuar çështjet dhe problemet lidhur me ngritjen e fermave bujqësore dhe blegtorale; cilat janë mënyrat më të mundshme për këtë aspekt,	Zyra e Koordinim Zhvillimit, zyra e gjendjes civile, ekspertë të informacionit	100,000 Lekë	Anketimi mund t'i adresohet vetëm fermerëve apo mund të përfshijë edhe grupe të tjerë të interesuarish në Komunë. Për kryerjen e anketimit, Komuna mund të angazhojë stafin e vet, apo të bashkëpunojë me shkollën e mesme të përgjithshme në fshatin Guri i Zi.
	A2a1	Ngritja e një ekipi teknik për vlerësimin e nevojave për investime dhe shërbime përgjatë korridorit kryesor ekonomik të Komunës	Kryetari i Komunës, Zyra e shërbimeve, teknike etj	0 Lekë	Qëllimi i grupit është të bashkërendojë punën për kryerjen e vlerësimit teknik. Përcaktimi i grupit duhet të shoqërohet me identifikimin e përgjegjësive për secilin si dhe rolin e tij/saj në proces
	A2a2	Përgatitja dhe kryerja e një pyetësori për bizneset ekzistuese, kryesisht përgjatë korridorit kryesor ekonomik të Komunës	Zyra e koordinim Zhvillimit, nxënës të shkollës së mesme të komunës, etj	50,000 Lekë	Qëllimi i pyetësorit është jo vetëm të identifikojë nevojat për përmirësime, por edhe të nxjerrë në pah mundësitë e angazhimit të biznesit vendor në Komunë në proceset e përmirësimit dhe të zhvillimit të klimës ekonomike
	A3a1	Përgatitja e një Studimi Teknik ku të përcaktohen format konkrete të zhvillimit të aktiviteteve turistike në zonën e Gurit të Zi si dhe cilat do të jenë nevojat për ndërhyrje dhe investime.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të fushës	100,000 Lekë	Në përgatitjen e këtij studimi duhet të angazhohen anëtarë të administratës së Komunës, specialistë si dhe grupe të interesuara. Qëllimi i këtij materiali është që të mundësojë dhe të orientojë rritjen e financimeve nga ana e operatorëve turistikë në këtë zonë.
B-Menaxhimi i Territorit	B1b1	Përgatitja dhe miratimi në Këshillin Vendor të Komunës Guri i Zi i një pakete masash penalizuese për ndërtimet në tokat bujqësore nën administrimin e Komunës.	Zyra ligjore, Zyra e shërbimeve, Kryetari i Komunës,	0 Lekë	Në kuadër të Ligjit të ri për Planifikimin e Territorit, Komuna ka për detyrë të monitorojë dhe të kontrollojë mënyrat e përdorimit të tokës, sidomos tokës bujqësore. Në bazë të kuadrit ligjor ekzistues është e ndaluar ndërtimi i objekteve në zona të konceptuara në territore bujqësore.
	B1b2	Përgatitja e materialeve informuese për banorët e Komunës Guri i Zi lidhur me masat që do të merren në rastet e ndërtimeve pa leje të objekteve.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikes	20,000 Lekë	Qëllimi i përgatitjes së materialeve të tilla informuese është të sensibilizojë banorët e Komunës lidhur me atë se si ata mund dhe se si duhet të ndërtojnë.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit	B2a1	Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës ku të diskutohen propozimet lidhur me kufijtë dhe mënyrën e zhvillimit urban në të ardhmen	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim -Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës	0 Lekë	Këto aktivitete mund të konceptohen si pjesë të proceseve pjesëmarrëse gjatë përgatitjes së Planeve Urbane për fshatrat e Komunës.
	B2c2	Përgatitja e bazës së të dhënave të nevojshme për hartimin e Planeve Urbane të fshatrave të Komunës	Zyra e Urbanistikës, ekspertë etj	200,000 Lekë	Megjithëse Komuna Guri i Zi nuk ka zyrë të urbanistikës, përgatitja e bazës së të dhënave është përgjegjësi e administratës së kësaj Komune. Baza e të dhënave të nevojshme duhet të krijohet sipas përcaktimeve të Ligjit për Urbanistikën (apo Ligjit të ri të Planifikimit të territorit)
	B2c3	Përgatitja e Detyrave të Projektimit për Planet Urbane të fshatrave	Zyra e Urbanistikës	0 Lekë	Ky aktivitet mund të kryhet në bashkëpunim me zyrën e urbanistikës së Qarkut Shkodër, duke mundësuar kështu një paraqitje sa më të qartë të kontekstit dhe objektivave të Planeve Urbane të Komunës.
	B2c4	Përgatitja e projekt propozimeve për donatorë të lidhur me mundësinë e financimit për përgatitjen e Planeve Urbane të fshatrave të Komunës	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë etj	0 Lekë	Këto propozime duhet të bazohen në përcaktimet hartografike të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe në bashkëpunimin me Qarkun Shkodër, si institucioni që duhet të miratojë Planet finale
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C1c2	Identifikimi i një plani investimesh në rrjetin rrugor në kuadër të zbatimit të propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit (materialet Hartografike)	Zyra e Urbanistikës, Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit	0 Lekë	Plani i investimeve nuk duhet të suprimojë planin ekzistues të investimeve që ka Komuna. Me tepër, ky plan i ri duhet të përfshihet në brendësi të kuadrit të investimeve që ka Komuna.
	C2a2	Krijimi i një baze të dhënash të përditësuara hartografike të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave	Zyra e Urbanistikës, Zyra e Koordinim Shvillimit, Zyra e Shërbimeve	100,000 Lekë	Duke qenë së Komuna nuk ka ekspertë për këtë proces, Zyra e Koordinimit mund të kontraktojë ekspertë të posaçëm apo inxhinierë të cilët do të krijojnë bazën e të dhënave hartografike. Kjo bazë duhet të konceptohet me sistemin e ri hartografik të miratuar për Shqipërinë.
	C4a2	Organizimi i një ankete në nivel Komune për çështjet që kanë të bëjnë me grumbullimin e mbetjeve në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Grupi i Punës, Shkolla e Mesme në Komunë.	100,000 Lekë	Në bazë të këtij anketimi do të identifikohen mënyrat dhe metodologjitë e përgatitjes dhe funksionimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C4b1	Organizimi i takimeve me përfaqësuesit e fshatrave të Komunës për të identifikuar dhe miratuar një pikë për depozitimin e përkohshëm të mbeturinave në Komunë.	Kryetari i Komunës, Kryepleqtë si dhe Zyra e Koordinim Zhvillimit dhe ekspertë mjedisorë.	0 Lekë	Duke qenë së të gjitha njësite vendore në Rajonin e Shkodrës do t'i depozitojnë mbetjet në pikën e re të Bushatit, është e nevojshme që Komuna të identifikojë një pikë të përkohshme depozitimi në territorin e saj, deri në përcaktimin real të kostove dhe procedurave për landfillin rajonal.
	C5a1	Përgatitja e një studimi teknik në terren për të identifikuar nevojën për përmirësime fizike dhe logjistike në të gjitha shkollat dhe kopshtet e Komunës.	Zyra e Urbanistikës, teknikë vlerësues etj.	250,000 Lekë	Ky studim do të merret si bazë (Detyrë Projektimi) për përgatitjen e projekteve të përmirësimit të shkollave dhe kopshteve në Komunë.
	C5b1	Përgatitja e disa projekte propozimesh drejtuar qeverisë qendrore apo donatorëve të ndryshëm lidhur me mundësinë e financimit të ndërhyrjeve përmirësuese në shkolla dhe në kopshte.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	Projekt propozimet mund të përgatiten edhe në bashkëpunim me Qarkun Shkodër si dhe me Drejtorinë Arsimore në Shkodër. Projektet duhet patjetër të bazohen në vlerësimin teknik të gjendjes ekzistuese të objekteve.
D-Qeverisja e Mirë	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes
	D2a2	Përgatitja e Raportit Vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjitha departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analizë i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e saja si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.
F- Burimet Financiare	F2a1	Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit të biznesit në Komunën Guri i Zi ku të trajtohen problemet që ata kanë si dhe mundësitë për bashkëpunim me autoritetet.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, etj	0 Lekë	Takimet do të organizohen dhe të moderohen nga zyra e Koordinim - Zhvillimit në Komunë, apo duke kontraktuar një ekspert të posaçëm. Është e rëndësishme që takimet të kenë paraqitje të mirë në mediat vendore duke krijuar kështu një sensibilizim të opinionit si dhe marketim të Komunës.

4.2.3 Plani i Veprimit – Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2010

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1a1	Vlerësimi teknik i të dhënave dhe bazës hartografike të tokës bujqësore në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë.	200,000 Lekë	Proçesi do të paraprihet edhe nga financimet e mundshme që mund të gjenerohen nga viti i kaluar nëpërmjet projekt propozimeve konkrete.
	A1a2	Krijimi i strukturës administrative të nevojshme për përmirësimin e bazës së të dhënave për tokën bujqësore (krijimi i një grupi përgjegjës).	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës.	0 Lekë	Në saje të Projekt Propozimeve të përgatitura më parë, Komuna identifikon përgjegjësin/t për krijimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave të tokës. Qëllimi i kësaj baze të dhënash është të orientojë Komunën në programimin e saj si dhe të lehtësoje proceset e përgatitjes së projekt propozimeve për zhvillimin e bujqësisë.
	A1b1	Lobim me fermerët vendor (bujqit dhe blegtorët) apo me shoqatat vendore për sa i përket krijimit të qendrës së informimit për bujqësinë si dhe mënyrës së funksionimit të saj, (hapja e një procesi takimesh dhe diskutimesh).	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, ekspertë të posaçëm.	100,000 Lekë	Ky proces mund të kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë si dhe me Ministrinë e linjës. Qëllimi i takimit është që të krijojë një platformë të qartë për Komunën dhe fermerët vendas lidhur me hapat që duhen ndjekur për zhvillimin e fermave bujqësore.
	A1d1	Përgatitja e një Studimi për vlerësimin e kapaciteteve prodhuese të Komunës për produkte bujqësore dhe blegtorale.	Ekspertë të bujqësisë	150,000 Lekë	Ky Studim do të përgatitet pikërisht duke u mbështetur në bazën e të dhënave të tokës bujqësore.
	A1e1	Hartimi i një vlerësimi teknik të gjendjes ekzistuese të rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në territorin e Komunës si dhe përcaktimi i ndërhyrjeve të nevojshme përmirësuese.	Inxhinierë të rrjetit, Zyra e Shërbimeve në Komunë, etj.	250,000 Lekë	Ky vlerësim do të shërbejë si material bazë për hartimin e Detyrave të Projektimit apo të Studimeve teknike për përmirësimin e rrjetit të ujësjellës kanalizimeve.
	A2a3	Finalizimi i Studimit Teknik duke përcaktuar ndërhyrjet e nevojshme në infrastruktura dhe shërbime për zhvillimin e korridorit ekonomik të Komunës.	Ekspertë teknikë, Zyra e Shërbimeve, etj.	50,000 Lekë	Studimi duhet të japë orientime se cilat duhet të jenë format e investimeve në këtë korridor, fazat e investimeve si dhe llojet e mundshme të bashkëpunimit me biznesin.
	A2b1	Përcaktimi i një programi ndërhyrjesh në funksion të gjetjeve të studimit teknik për korridorin kryesor ekonomik të Komunës.	Kryetari i Komunës, Zyra e Financës, Zyra e Shërbimeve	0 Lekë	Programi do të paraqitet para Këshillit Vendor të Komunës për miratim.
	A3a2	Diskutimi i profilit të zhvillimit të agroturizmit me përfaqësuesit kryesorë në Komunë si dhe në Rajonin e Shkodrës ku të gjenerohen ide të reja dhe mundësi konkrete investimi.	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit	0 Lekë	Vetë ky aktivitet mund të gjenerojë në një Plan Veprimesh specifike të cilat do të mund të zbatohen nga administrata e Komunës apo edhe nga prodhuesit dhe investitorët vendorë.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit	B1c1	Përgatitja dhe diskutimi i një pakete taksash të posaçme për ndërtimet ekzistuese në territoret urbane dhe ato bujqësore të Komunës në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore si dhe me Ligjin për Taksat Vendore.	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Financës, Zyra ligjore.	0 Lekë	Ky proces do të synojë rritjen e të ardhurave vendore të Komunës, për të mundësuar kështu rritjen e investimeve apo përmirësimin e gjendjes së hapësirave apo infrastrukturave urbane në këtë Komunë.
	B1d1	Identifikimi në terren i kufijve të zonave të propozuara urbane të fshatrave të Komunës Guri i Zi.	Topografë, Zyra e urbanistikës etj.	200,000 Lekë	Kufijtë do t'i referohen materialeve hartografike dhe ndërhyrjeve që propozohen në Planin Strategjik të Zhvillimit.
	B1d2	Përgatitja e një vlerësimi teknik lidhur me nevojat për infrastrukturë në zonat e përcaktuara të konsolidimit urban të Komunës.	Inxhinierë të posaçëm, Zyra e Urbanistikës.	100,000 Lekë	Bëhet fjalë për zonat përgjatë rrugës kryesore, si Guri i Zi, Juban, fshatit Vukatanë si dhe disa zona të Gajtanit dhe Rrancës. Në materialet hartografike të propozuara, këto zona duhet të kenë Studime Urbane Specifike.
	B1e1	Vlerësimi në terren dhe përgatitja e një materiali të plotë hartografik ku të përcaktohen zonat e dëmtuara dhe të rrezikuara në territorin e Komunës si dhe nevojat për ndërhyrje përmirësuese.	Ekspertë teknikë, zyra e Urbanistikës.	100,000 Lekë	Materiali hartografik i bashkëngjitur mund t'i bashkëngjitet hartave të Planit Strategjik të Zhvillimit. Ky material do të shërbejë si terma reference për përpunimin e projekteve të ndërhyrjes apo projekt propozimeve.
	B2a1	Përgatitja dhe vendosja e tabelave informuese në fshatrat e Komunës ku të qartësohen kufijtë e propozuar në materialet hartografike të Planit si dhe profilet e rrugëve kryesore.	Teknikë, Zyra e Urbanistikës, etj	100,000 Lekë	Qëllimi i tabelave është që të stimulojë gradualisht respektimin e rregullave të vendosura për zhvillimin e territorit në Komunë si dhe të disiplinojë ndërtimet e ardhshme në këto territore.
	B2b1	Organizimi dhe mbështetja e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të administratës për kontrollin dhe administrimin e territorit në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit,	300,000 Lekë	Duke qenë së Komuna nuk ka zyrë urbanistike, dhënia e trajnimeve të tilla do të rrisë kapacitetet e stafit të Komunës, dhe të stimulojë krijimin e një Zyre Urbanistike në të.
	B2c4	Përgatitja e projekt propozimeve për donatorë të lidhur me mundësinë e financimit për përgatitjen e Planeve Urbane të fshatrave të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë etj.	0 Lekë	Projekt propozimet do të bazohen në kufijtë e propozuar të materialeve hartografike në Planin Strategjik të të Zhvillimit. Komuna mund të angazhojë edhe ekspertë të posaçëm për finalizimin e këtyre projekt propozimeve.
	B3a2	Përgatitja dhe vendosja e tabelave informuese në qendër dhe në fshatrat e Komunës ku të specifikohen zonat problematike mjedisore në Komunë.	Zyra e Urbanistikës, ekspertë të mjedisit, etj.	200,000 Lekë	Qëllimi është që të sensibilizojnë banorët për zonat problematike, duke stimuluar kështu mundësinë e reagimit të tyre në mbrojtje të mjedisit.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C1a1	Përgatitja e një studimi teknik lidhur me gjendjen ekzistuese të rrugëve të Komunës Guri i Zi ku të evidentohen qartë akset e dëmtuara, akset që kanë nevojë për ndërhyrje emergjente si dhe akset për rrugët e mëvonshme.	Inxhinierë të posaçëm, Zyra e Urbanistikës, etj.	200,000 Lekë	Studimi do të finalizohet me një paketë materialesh të përmbledhura, të cilat do të shërbejnë si pika referimi (Terma Reference) për përgatitjen e planeve fizike të mëvonshme.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C1a2	Organizimi i takimeve me komunitetet vendore të fshatrave të Komunës për të diskutuar dhe përcaktuar nevojat për ndërhyrje në rrjetet rrugore.	Zyra e Urbanistikës, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i takimeve është që të orientojë sa më mirë mundësitë e pakta për investime në këtë Komunë, duke qartësuar nevojat reale që ka popullsia.
	C1b1	Përgatitja e Detyrave të Projektimit për projektet e rikonstruksionit të rrugëve në fshatrat e Komunës.	Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë	100,000 Lekë	Këto dokumente do të bazohen pikërisht në studimin teknik të mësipërm si dhe reagimet e banorëve të zonës lidhur me nevojat për investime në këtë profil.
	C2a1	Hartimi i një studimi fizibiliteti lidhur me nevojat për furnizim me ujë për banorët, gjendjen ekzistuese të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave të Komunës si dhe nevojat për investime në të ardhmen.	Ekspertë teknikë,	300,000 Lekë	Studimi duhet të bazohet në propozimet e Planit Strategjik të Zhvillimit nga pikëpamja e shtrirjes territoriale të zonave urbane (fshatrave) si dhe të infrastrukturave kryesore. Studimi duhet të merret parasysh gjatë përgatitjes së Planeve Urbane të fshatrave.
	C2a3	Kryerja e inventarizimit të aseteve të ujësjellësve të fshatrave dhe miratimi i tyre në Këshillin Vendor të Komunës.	Ekspertë teknike, Zyra e Urbanistikës.	0 Lekë	Miratimi i inventarit të ujësjellësve nga ana e Këshillit Vendor shërben si dokument bazë që lehtëson proceset e projektimit dhe financimit të rrjeteve të ujësjellësve në fshatra.
	C2b1	Përgatitja e projekteve teknike për rrjetet e ujësjellësve të fshatrave të Komunës ku mungon ky shërbim.	Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë	500,000 Lekë	Projektet duhet të bazohen në përcaktimet territoriale të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të përputhen me Planet e reja Urbane të fshatrave.
	C3a2	Organizimi i takimeve periodike me Qarkun Shkodër, donatorë apo me investitorë të mundshëm për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve në fshatrat e Komunës.	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit, etj.	20,000 Lekë	Takimet duhet të bazohen në përcaktimet territoriale të Planit Strategjik të Zhvillimit dhe në mënyre specifike tek zonat e konsolidimit urban.
	C4b2	Përgatitja e vlerësimit të ndikimit në mjedis të pikës së përkohshme të grumbullimit të mbeturinave në Komunë	Ekspertë, inxhiniere mjedisi.	200.000 Lekë	Kjo do të shërbej për të kuptuar ndotjen që do të shkaktoj ky venddepozitim dhe masat që duhen marrë për të evituar efektet negative të tij.
	C5b1	Përgatitja e disa projekte propozimesh drejtuar qeverisë qendrore apo donatorëve të ndryshëm lidhur me mundësinë e financimit të ndërhyrjeve përmirësuese në shkolla dhe në kopshte.	Zyra e Koordinim Zhvillimit,	0 Lekë	Projekt propozimet do të mund të shërbejnë për aplikime të shpeshta dhe të shumta.
	C5b2	Përgatitja e projekteve teknike të ndërhyrjeve përmirësuese në objektet sociale në Komunë ku të evidentohen qartë llojet dhe volumet e ndërhyrjeve si dhe kostot përkatëse.	Ekspertë të posaçëm, Zyra e Urbanistikës	500,000 Lekë	Projektet teknike do t'i paraprijnë financimeve të ndryshme, apo të shërbejnë si pjesë të aplikimeve me projekt propozime.
D-Qeverisja e Mire	D1a1	Përgatita e një analize të plotë institucionale në nivel Komune ku të trajtohen çështje të funksioneve të Komunës, shpenzimeve që ajo kryen si dhe nevojat për përmirësimin e eficiences së punës së administratës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, ekspertë	100,000 Lekë	Analiza institucionale do të bazohet në mundësinë e administratës për zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të propozimeve dhe aktiviteteve.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
D-Qeverisja e Mire	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit,	50,000 Lekë	Qëllimi i Gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes
	D2a2	Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjithë departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analizë i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e saja si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.
F- Burimet Financiare	F2a1	Organizimi i takimeve me përfaqësues të komunitetit të biznesit në Komunën Guri i Zi ku të trajtohen problemet që ata kanë si dhe mundësitë për bashkëpunim me autoritetet vendore të Komunës	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, etj	0 Lekë	Këto aktivitete periodike do të mundësojnë identifikimin e aktiviteteve të nevojshme të përbashkëta me biznesin vendor në Komunë. Përveç kësaj, gjetjet e këtij procesi do të mund të konsiderohen edhe gjatë procesit të vlerësimit dhe monitorimit vjetor të Planit.

4.2.4 Plani i Veprimit – Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2011

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1b2	Krijimi i një qendre informacioni në nivel Komune (zyre e posaçme informimi) për bujqësinë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, ekspertë.	100,000 Lekë	Qëllimi i qendrës së informimit është rritja e nivelit të transparencës të Komunës me qytetarët si dhe informimi i tyre për proceset e Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe procese të tjera administrative.
	A1b3	Investime në sistemet elektronike të informacionit lidhur me çmimet e produkteve bujqësore dhe blegtorale (linjë interneti).	Ekspertë të posaçëm, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200,000 Lekë	Linja e internetit do të shërbejë edhe për rritjen e nivelit të informacionit profesional në Komunë si dhe në shkëmbimin e të dhënave.
	A1c2	Përgatitja e një studimi / plan biznesi i mundësisë së krijimit të fermave bujqësore dhe blegtorale.	Ekspertë të posaçëm, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	100,000 Lekë	Studimi do të merret parasysh gjatë hartimit të Projekt Propozimeve apo në vlerësimin dhe monitorimin vjetor të Komunës. Në saje të këtij studimi, Komuna mund të identifikojë fonde të posaçme për investime në këtë sektor.
	A1c3	Organizimi i një forumi periodik, të hapur me bujqit dhe blegtorët në Komunë, për të marre opinionet e tyre për mundësinë / problemet e krijimit të fermave.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Kryetari i Komunës, ekspertë të bujqësisë	150,000 Lekë	Ky forum do të stimulojë dhe rrisë nivelin e informacionit të autoriteteve vendore lidhur me mundësitë e zhvillimit të bujqësisë dhe në krijimin e fermave.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1d2	Përgatitja e materialeve promovuese të Komunës Guri i Zi lidhur me kapacitetet prodhuese bujqësore dhe blegtorale të saj si dhe publikimi i tyre.	Ekspertë të posaçëm, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	100,000 Lekë	Në këtë mënyrë rriten shanset për investime konkrete në zonë, si dhe stimulohet prodhimi vendas nëpërmjet marketimit të produkteve ekzistuese.
	A1e2	Përgatitja e projekteve konkrete teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të tokave bujqësore në Komunë.	Ekspertë teknikë.	300,000 Lekë	Projektet do të shërbejnë gjatë fazës së hartimit të projekt propozimeve për financim drejtuar donatorëve të mundshëm në zonë apo në rajon.
	A2b2	Kryerja e ndërhyrjeve të vogla përmirësuese në infrastrukturat e korridorit kryesor ekonomik të Komunës	Zyra e Shërbimeve, Zyra e Financës, Kryetari i Komunës	1,000,000 Lekë	Ndërhyrjet do të konsistojnë në riparimin e dëmtimeve në aksin rrugor, përmirësime në ndriçim, në sigurinë rrugore etj
B-Menaxhimi i Territorit	B1a3	Nisja e bashkëpunimit me komunat fqinje si dhe me Qarkun Shkodër për sa i përket mbështetjes dhe koordinimit të kontrollit mbi token bujqësore.	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	Duke qenë se thuajse të gjitha njësitë vendore fqinje me Komunën Guri i Zi paraqesin të njëjtat problematika, është e rëndësishme krijimi i një linje bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.
	B1d3	Përgatitja e projekteve të ndryshme për financim lidhur me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturave në zonat e propozuara të konsolidimit urban në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit dhe ekspertë të posaçëm.	100,000 Lekë	Projekt propozimet do të bazohen në materialet e propozuara hartografike të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe duhet të jenë në kohezion me proceset e përgatitjes së Planeve të rinj Urbanë.
	B1e3	Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës lidhur me nevojën për mbrojtjen e zonave të rrezikuara dhe të dëmtuara si dhe diskutimin e mundësive të ndërhyrjeve si dhe financimeve të nevojshme.	Kryetari i Komunës, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	Pas identifikimit të zonave të dëmtuara, organizimi i takimeve do të rrisë ndjeshmërinë e banorëve si dhe të stimulojë reagimin e tyre në mbrojtje të mjedisit në Komunë.
	B2b3	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financimin e mundshëm të konsolidimit të bazës së të dhënave urbanistike të Komunës Guri i Zi lidhur me projektet e ndërtesave ekzistuese apo dhe infrastrukturave përkatëse.	Ekspertë të posaçëm teknike, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	100,000 Lekë	Kjo bazë të dhënash do të shërbejë për çështjet e vendosjes dhe menaxhimit të taksës së pasurisë në Komunë si dhe për çështje të menaxhimit urban.
	B3a1	Organizimi i aktiviteteve periodike në nivel Komune ku të trajtohen dhe të referohen problemet aktuale që ka Komuna lidhur me dëmtimet në mjedis.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të mjedisit.	150,000 Lekë	Aktiviteti i propozuar ka fokus kryesor rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve në Komunë lidhur me mjedisin dhe problemet e tij.
	B3b1	Përgatitja e një programi ndërhyrjeje në mjedis.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të mjedisit.	300,000 Lekë	Në bazë të aktivitetit të mësipërm, paketa e përcaktuar e veprimeve mund të merret parasysh gjatë reflektimit dhe monitorimit vjetor të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit	B3b3	Përgatitja e projekteve teknike për financim për zonat e dëmtuara apo të rrezikuara në territorin e Komunës	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të posaçëm teknikë.	200,000 Lekë	Projektet do të jenë pjesë e propozimeve për financim që do të përgatiten nga Zyra e Koordinim Zhvillimit.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet.	C1b2	Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e projekteve teknike të rrugëve të Komunës.	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit, Inxhinierë	200,000 Lekë	Në bazë të Detyrave të Projektimit të përgatitura, projekt propozimet do të adresojnë ato akse rrugore që identifikohen të rëndësishëm nga banorët vendorë të Komunës.
	C1c1	Planifikimi dhe prokurimi i investimeve të vogla periodike vjetore për përmirësimin e rrjetit rrugor të Komunës.	Zyra e Financës, Kryetari i Komunës, Këshilli Vendor i Komunës.	0 Lekë	Këto investime do të financohen nëpërmjet fondeve në gjendje të Komunës Guri i Zi.
	C2b2	Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrjeteve të ujësjellësve të fshatrave të Komunës Guri i Zi.	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200,000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	C5c1	Organizimi i takimeve periodike në nivel Komune midis grupeve mësimore si dhe përfaqësuesve të prindërve lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies si dhe kushteve në shkollat e Komunës Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Drejtoritë e shkollave në Komunë.	0 Lekë	Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që të identifikojnë problemet ekzistuese të shkollave si dhe të sensibilizojnë banorët për nevojën e transformimit të sektorit arsimor në këtë Komunë.
D-Qeverisja e Mirë.	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i Gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes.
	D2a2	Përgatitja e Raportit Vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi,	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjithë departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analize i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e veta si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.

4.2.5 Plani i Veprimit – Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2012

Objektivat e Zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1b3	Investime në sistemet elektronike të informacionit lidhur me çmimet e produkteve bujqësore dhe blegtorale (linjë interneti).	Ekspertë të informacionit, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	150,000 Lekë	Linja e internetit do të shërbejë edhe për rritjen e nivelit të informacionit profesional në Komunë si dhe në shkëmbimin e të dhënave.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A1c3	Organizimi i një forumi periodik, të hapur me bujqit dhe blegtorët në Komunë, për të marre opinionet e tyre për mundësinë / problemet e krijimit të fermave.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Fermerë vendorë.	0 Lekë	Ky forum do të stimulojë dhe rrisë nivelin e informacionit të autoriteteve vendore lidhur me mundësitë e zhvillimit të bujqësisë dhe në krijimin e fermave.
	A1e2	Përgatitja e Projekteve konkrete teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve të tokave bujqësore në Komunë.	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200,000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	A1e3	Organizimi i takimeve periodike me Bordin e Kullimit lidhur me mundësinë e ndërhyrjes në rrjetin e kanaleve kulluese në zonë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	Këto takime do të përmirësojnë gjendjen e sistemit të kanaleve kulluese në Komunë.
	A2b3	Përgatitja e Projekt Propozimeve të ndryshme për përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve në korridorin ekonomik të Komunës.	Zyra e shërbimeve, Zyra e Financës, Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë.	50,000 Lekë	Qëllimi i këtyre dokumenteve do të jetë rritja e kapaciteteve financiare të Komunës për të ndërhyrë në korridor ekonomik, duke përfshirë në proces edhe vetë bizneset ekzistuese.
	A3b1	Përgatitja e projekteve teknike për infrastrukturat turistike në Komunës.	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200,000 Lekë	Në këtë mënyrë rriten shanset për investime konkrete në zonë, si dhe stimulohet turizmi vendor.
	A3b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financim nga donatorë të ndryshëm për infrastrukturat turistike në Komunë.	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit.		Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
B-Menaxhimi i Territorit	B1d3	Përgatitja e Projekteve të ndryshme për financim lidhur me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturave në zonat e propozuara të konsolidimit urban në Komunën Guri i Zi	Ekspertë të posaçëm teknikë, Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës.	250,000 Lekë	Ky proces do të synojë rritjen e të ardhurave vendore të Komunës, për të mundësuar kështu rritjen e investimeve apo përmirësimin e gjendjes së hapësirave apo infrastrukturave urbane në këtë Komunë
	B1e2	Përgatitja e projekt propozimeve lidhur me përmirësimin e gjendjes së zonave të dëmtuara dhe të rrezikuara.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	B1e3	Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës lidhur me nevojën për mbrojtjen e zonave të rrezikuara dhe të dëmtuara si dhe diskutimin e mundësive të ndërhyrjeve si dhe financimeve të nevojshme.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	Këto takime do të shërbejnë edhe si Terma Reference për përpunimin e projekteve të ndërhyrjes apo projekt propozimeve.
	B1e4	Kryerja e investimeve të vogla përmirësuese për zonat e dëmtuara në Komunë.	Zyra e shërbimeve, Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Kjo do të çojë në përmirësimin e imazhit të Komunës.
	B2b2	Investimi për përmirësimin e bazës teknike për administrimin dhe monitorimin e territorit në Komunë, duke u fokusuar në arkivimin e të dhënave teknike dhe hartografike.	Zyra e Urbanistikës.	100.000 Lekë	Kjo do të ndihmojë në organizimin e punës së Zyrës së Urbanistikës.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit	B2b3	Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e mundshëm të konsolidimit të bazës së të dhënave urbanistike të Komunës Guri i Zi lidhur me projektet e ndërtesave ekzistuese apo dhe infrastrukturave përkatëse.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashme të finalizuar në Komunë.
	B3a1	Organizimi i aktiviteteve periodike në nivel Komune ku të trajtohen dhe të referohen problemet aktuale që ka Komuna lidhur me dëmtimet në mjedis.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë mjedisi.	100.000 Lekë	Këto aktivitete do të shërbejnë për të sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar banorët për ndotjen e mjedisit dhe masat që duhet të marre gjithsecili për të përmirësuar situatën.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet.	C1b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financimin e projekteve teknike të rrugëve të Komunës.	Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës.	200.000 Lekë	Ky proces do të synojë rritjen e të ardhurave vendore të Komunës, për të mundësuar kështu rritjen e investimeve apo përmirësimin e gjendjes së hapësirave apo infrastrukturave urbane në këtë Komunë.
	C1c1	Planifikimi dhe prokurimi i investimeve të vogla periodike vjetore për përmirësimin e rrjetit rrugor të Komunës.	Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Kjo do të jetë shumë e rëndësishme edhe për mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese.
	C2c1	Përgatitja e një vlerësimi nevojash për rritje kapacitetesh për menaxhimin e rrjeteve të ujësjellësve në Komunë.	Zyra e Koordinim zhvillimit, inxhinierë të fushës.	250.000 Lekë	Mund të organizohen trajnime të ndryshme në fushën hidro-inxhinjerike.
	C2c2	Organizimi dhe mbështetja e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit përkatës për menaxhimin dhe kontrollin e rrjeteve të ujësjellësve në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, inxhinierë të fushës.	200.000 Lekë	Modulet e trajnimit mund të përgatiten dhe finalizohen nga Intercooperation Albania.
	C3a1	Përgatitja e projekt propozimeve drejtuar donatorëve të ndryshëm për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve të fshatrave të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, inxhinierë të fushës.	100.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashme të finalizuar në Komunë.
	C3b1	Përgatitja e projekteve të plota teknike për rrjetet e kanalizimeve në Komunën Guri i Zi.	Inxhinierë të fushës, ekspertë.	100.000 Lekë	Këto projekte do të përmirësojnë situatën e përgjithshme të rrjetit të kanalizimeve.
	C5c1	Organizimi i takimeve periodike në nivel Komune midis grupeve mësimore si dhe përfaqësuesve të prindërve lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies si dhe kushteve në shkollat e Komunës Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Drejtoritë e Shkollave në Komunë.	0 Lekë	Këto takime do të lehtësojnë dhe përmirësojnë nivelin e mësimdhënies në shkollat e Komunës.
D-Qeverisja e Mirë	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i Gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
D-Qeverisja e Mirë	D2a2	Përgatitja e Raportit Vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi,	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjitha departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analize i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e veta si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.
F- Burimet Financiare	F1a1	Përgatitja e një studimi konkret për të identifikuar të ardhurat potenciale që mund të gjenerojë Komuna Guri i Zi nga taksat e pronës (toka bujqësore si dhe banesat).	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës, Zyra e Shërbimeve.	0 Lekë	Ky studim duhet të jetë konkret dhe i detajuar në mënyrë që të mundësojë të ardhura të mjaftueshme për Komunën Guri i Zi.
	F1a2	Ngritja e një sistemi informacioni të posaçëm për vlerësimin dhe monitorimin e grumbullimit të taksave vendore të Komunës.	Zyra e Shërbimeve.	150.000 Lekë	Ky sistem do të ndihmojë për grumbullimin e taksave në masën e kërkuar.
	F2b2	Organizimi i panaireve në zonën e Komunës Guri i Zi ku të ekspozohen vlerat dhe produktet që ka kjo zonë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	100.000 Lekë	Këto panaire do të synojnë të reklamojnë produktet e ndryshme bujqësore/blegtorale të zonës.
	F2b3	Përgatitja e projekteve të ndryshme drejtuar donatorëve të ndryshëm për financim.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	150.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashme të finalizuar në Komunë.

4.2.6 Plani i Veprimit – Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2013

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik.	A1c3	Organizimi i një forumi periodik, të hapur me bujqit dhe blegtorët në Komunë, për të marrë opinionet e tyre për mundësinë / problemet e krijimit të fermave.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, fermerë vendorë.	0 Lekë	Ky forum do të ndihmojë fermerët e Komunës për t'i orientuar ata drejt krijimit të fermave dhe rritjes së eficences.
	A3b1	Përgatitja e Projekteve Teknike për infrastrukturat turistike të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë.	200.000 Lekë	
	A3b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financim nga donatorë të ndryshëm për infrastrukturat turistike në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë.	200.000 Lekë	Projekt Propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
B-Menaxhimi i Territorit.	B1e3	Organizimi i takimeve me banorët e fshatrave të Komunës lidhur me nevojën për mbrojtjen e zonave të rrezikuara dhe të dëmtuara si dhe diskutimin e mundësive të ndërhyrjeve si dhe financimeve të nevojshme.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	0 Lekë	
	B1e4	Kryerja e investimeve të vogla përmirësuese për zonat e dëmtuara në Komunë.	Zyra e Shërbimeve, teknikë.	300.000 Lekë	Kjo do të shërbejë për të përmirësuar imazhin e zonës.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
B-Menaxhimi i Territorit.	B2b3	Përgatitja e Projekteve të ndryshme për financim lidhur me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturave në zonat e propozuara të konsolidimit urban në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200.000 Lekë	Projekt Propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	B2b2	Investimi për përmirësimin e bazës teknike për administrimin dhe monitorimin e territorit në Komunë, duke u fokusuar në arkivimin e të dhënave teknike dhe hartografike.	Zyra e Urbanistikës	150.000 Lekë	Kjo do të ndihmojë në organizimin e punës së Zyrës së Urbanistikës.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet	C1b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financimin e projekteve teknike të rrugëve të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës.	200.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me Projektet Teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	C1c1	Planifikimi dhe prokurimi i investimeve të vogla periodike vjetore për përmirësimin e rrjetit rrugor të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Kjo do të shërbejë për të mirëmbajtur gjendjen e rrugëve të Komunës.
	C2c2	Organizimi dhe mbështetja e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit përkatës për menaxhimin dhe kontrollin e rrjeteve të ujësjellësve në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë.	Lekë	Modulet e trajnimit mund të përgatiten dhe finalizohen nga Intercooperation Albania.
	C3a1	Përgatitja e Projekt Propozimeve drejtuar donatorëve të ndryshëm për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve të fshatrave të Komunës.	Zyra e Urbanistikës.	100.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	C3b1	Përgatitja e projekteve të plota teknike për rrjetet e kanalizimeve në Komunën Gur i Zi.	Zyra e Urbanistikës.	150.000 Lekë	Këto projekte do të shërbejnë për të përmirësuar gjendjen e rënduar të rrjetit të kanalizimeve në fshatrat e Komunës.
	C3b2	Diskutimi dhe përcaktimi i një pike për depozitimin dhe dekantimin e ujërave të zeza për fshatrat e zonës fushore në Komunë.	Zyra e Urbanistikës, inxhinierë, ekspertë.	0 Lekë	Kjo është shumë e rëndësishme për Komunën pasi eliminon problemet aktuale të këtyre fshatrave.
	C5c1	Organizimi i takimeve periodike në nivel Komune midis grupeve mësimore si dhe përfaqësuesve të prindërve lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies si dhe kushteve në shkollat e Komunës Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, arsimtarë të zonës.	0 Lekë	Këto takime do të ndihmojnë dhe lehtësojnë procesin e mësimdhënies në Komunë.
D-Qeverisja e Mirë.	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i Gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
D-Qeverisja e Mirë.	D2a2	Përgatitja e Raportit Vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjithë departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analizë i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e saj si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.
F-Burimet Financiare	F2b1	Përgatitja e materialeve promovuese, postera, fletëpalosje, etj, ku të paraqiten anët pozitive të Komunës, zonat me interes investimi, zonat me vlera natyrore, historike, turistike etj.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	150.000 Lekë	Ky material do të ndihmojë në promovimin e përgjithshme të Komunës dhe vlerave të saj por edhe të thithë në këtë mënyrë sa më shume investime nga donatorë të huaj.
	F2b2	Organizimi i panaireve në zonën e Komunës Guri i Zi ku të ekspozohen vlerat dhe produktet që ka kjo zonë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, fermerë lokale.	100.000 Lekë	Në këtë mënyrë do të reklamohen më së miri produktet e fermerëve vendas.
	F2c1	Përgatitja e Projekteve të ndryshme drejtuar donatorëve të ndryshëm për financim.	Zyra e Koordinim zhvillimit, ekspertë.	150.000 Lekë	Projekt propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.

4.2.7 Plani i Veprimit – Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës Guri i Zi

Viti 2014

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
A-Zhvillimi Ekonomik	A3b1	Përgatitja e Projekteve Teknike për infrastrukturat turistike në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	200.000 Lekë	Këto do të shërbejnë për të investuar dhe ndërhyrë sa më shpejt dhe në mënyrë eficiente në shërbim të promovimit të turizmit vendor.
	A3b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financim nga donatorë të ndryshëm për infrastrukturat turistike në Komunë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	150.000 Lekë	Projekt Propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
B-Menaxhimi i Tokës.	B1e4	Kryerja e investimeve të vogla përmirësuese për zonat e dëmtuara në Komunë.	Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës.	200. 000 Lekë	Këto investime do të përmirësojnë imazhin e fshatrave të Komunës.
C-Infrastrukturat dhe Shërbimet.	C1b2	Përgatitja e Projekt Propozimeve për financimin e projekteve teknike të rrugëve të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	150.000 Lekë	Projekt Propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.
	C1c1	Planifikimi dhe prokurimi i investimeve të vogla periodike vjetore për përmirësimin e rrjetit rrugor të Komunës.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	300.000 Lekë	Kjo do të shërbejë për të mirëmbajtur gjendjen e rrugëve të Komunës.
	C3b1	Përgatitja e Projekteve të plota teknike për rrjetet e kanalizimeve në Komunën Gur i Zi.	Zyra e Urbanistikës, inxhinierë.	100.000 Lekë	Këto projekte do të mundësojnë më vonë investimet dhe ndërhyrjet e nevojshme në këtë sektor të shërbimeve.
	C3b2	Diskutimi dhe përcaktimi i një pike për depozitimin dhe dekantimin e ujërave të zeza për fshatrat e zonës fushore në Komunë.	Zyra e Shërbimeve, Inxhinierë të fushës.	0 Lekë	Kjo është shumë e rëndësishme për Komunën pasi eliminon problemet aktuale të këtyre fshatrave.

Objektivat e zhvillimit	Kodi	Ndërhyrje konkrete	Aktorët përgjegjës	Buxheti Indikativ	Shpjegime
C-**Infrastrukturat dhe Shërbimet.**	C5c1	Organizimi i takimeve periodike në nivel Komune midis grupeve mësimore si dhe përfaqësuesve të prindërve lidhur me mundësinë e përmirësimit të mësimdhënies si dhe kushteve në shkollat e Komunës Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, drejtoritë e shkollave.	0 Lekë	Këto takime do të ndihmojnë dhe lehtësojnë proçesin e mësimdhënies në Komunë.
D-Qeverisja e Mirë.	D2a1	Përgatitja dhe shpërndarja e Gazetës Informative në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	50,000 Lekë	Qëllimi i gazetës është që të rrisë mundësitë e shkëmbimit të informacionit lidhur me vendimmarrjen në Komunë si dhe të promovojë reagimin e publikut për sa i përket çështjeve të vendimmarrjes.
	D2a2	Përgatitja e Raportit Vjetor për aktivitetet, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Komunën Guri i Zi.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, të gjitha departamentet e administratës.	50,000 Lekë	Raporti Vjetor duhet të shërbejë si një dokument analizë i cili do të reflektojë arritjet e administratës në përgjegjësitë e saja si dhe në zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit.
F-Burimet Financiare.	F2b2	Organizimi i panaireve në zonën e Komunës Guri i Zi ku të ekspozohen vlerat dhe produktet që ka kjo zonë.	Zyra e Koordinim Zhvillimit.	100.000 Lekë	Kjo do ndihmojë në promovimin e vlerave vendore.
	F2c1	Përgatitja e Projekteve të ndryshme drejtuar donatorëve të ndryshëm për financim.	Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë.	150.000 Lekë	Projekt Propozimet do të shoqërohen me projektet teknike tashmë të finalizuar në Komunë.

4.3 Skema e Monitorimit dhe Treguesit Përkatës

Zbatimi i suksesshëm i Planit Strategjik të Zhvillimit në Komunën Guri i Zi ka nevojë për konsolidimin e një sistemi të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë bëhet e mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit të Veprimit si dhe të përcaktohen ndryshimet apo adaptimet e nevojshme. Plani Strategjik i Zhvillimit të Komunës i referohet një periudhe të shkurtër kohore 2008 – 2014, dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjesh të nevojshme.

Duke qenë së Plani është një dokument strategjik në shërbim të Komunës Gur i Zi, është e natyrshme që zbatimi dhe monitorimi i tij të kryhet sipas proceseve të funksionimit dhe planifikimit të pushtetit vendor. Kjo mund të thuhet edhe për sinkronizimin e aktiviteteve të propozuara me fazat elektorale të zgjedhjes së pushtetit vendor në Shqipëri. Në këtë mënyrë sigurohet edhe përshtatja e propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimi i zbatimit të tij me ciklet e planifikimit vjetor dhe buxhetimit të administratës.

Bazuar në Ligjin për Financat Publike, përgatitja e Projekt Buxhetit për tre vitet në vazhdim, është një proces që duhet të finalizohet në muajin Korrik të çdo viti. Ky projekt buxhet bazohet në Udhëzimin e Qeverisë për përgatitjen e projekt buxhetit të të gjitha njësive vendore në periudhën Qershor-Korrik. Ky Projekt Buxhet parashikon shpenzimet dhe investimet e Komunës Guri i Zi për tre vitet në vazhdim, ndërsa Plan Buxheti, që përgatitet dhe miratohet nga Këshilli Vendor si dhe nga Prefektura Shkodër brenda Dhjetorit, trajton vetëm vitin pasardhës. Përgatitja e projekt investimeve për Grantet Konkurruese është një proces që duhet të përfundojë deri në 1 Nëntor të çdo viti. Plan Buxheti vjetor mund ose jo të përfshijë këto projekte në strukturën e tij.

Skema e propozuar e monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit

Aktiviteti i propozuar	Afati kohor (për çdo vit)	Aktorët përgjegjës	Lidhja me planifikimin dhe buxhetimin vjetor
Vlerësimi 6 mujor i aktiviteteve të Planit të Veprimit të PSZH; Përgatitje e Progres Raportit	Prill - Maj	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit.	Duke u bazuar në rezultatet e 6 mujorit, Komuna mund të përcaktojë ndryshimet në Projekt Buxhetin që dorëzohet në korrik.
Takime publike me qytetarët për rezultatet e zbatimit të PSZH.	Qershor - Korrik	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit.	Ndikojnë në adoptimet e nevojshme të aktiviteteve në Plan Buxhetin final.
Takim i stafit të administratës së Komunës për të diskutuar progresin si dhe ndryshimet e nevojshme.	Tetor - Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Komunës	Takimi do të finalizojë ndryshimet dhe adoptimet e nevojshme të Planit të Aktiviteteve që do të reflektohen në Buxhetin e ri vjetor të dhjetorit.
Takim vjetor për vlerësimin dhe monitorimin e PSZH; Përgatitje a raportit vjetor.	Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Komunës.	Takimi final i paraprin finalizimit dhe dorëzimit të Buxhetit Vjetor të Komunës.

Në fund të çdo vlerësim,i Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmbledhës i cili do të paraqitet para Këshillit të Komunës Guri i Zi. Ky i fundit, ruan të drejtën që për çdo rast, të bëj kërkesë për raportim shtesë nëse e gjykon të nevojshme.

PLANI STRATEGJIK
I ZHVILLIMIT
TË KOMUNËS GURI I ZI